

KËRKOJME DINJITET!



KËRKOJME DINJITET!



KËRKOJME DINJITET!

KËRKOJME DINJITET!

KËRKOJME DINJITET!

KË

NË KËRKIM TË NJË STREHE

LARGIMI NGA PËRKUJDESI
SOCIAL NË SHQIPËRI

STREHIMI ËSHTË NJË
E DREJTË E NJERIUT

AMNESTY
INTERNATIONAL



Amnesty International është një lëvizje globale prej 2,8 milion njerëzish në më shumë se 150 vende dhe territore të botës, që bëjnë fushatë për t'i dhënë fund shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Vizioni ynë është që gjithsecili të gëzojë të gjitha të drejtat e mishëruara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe standarde të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ne jemi të pavarur nga çdo lloj qeverie, ideologjie politike, interesi ekonomik apo besimi fetar – dhe financohemi kryesisht nga anëtarësimet dhe donacionet publike.

**AMNESTY
INTERNATIONAL**



Botime të Amnesty International

Botuar për herë të parë në 2010-n nga
Amnesty International Publications
International Secretariat
Peter Benenson House
1 Easton Street
London WC1X 0DW
United Kingdom
www.amnesty.org

© Amnesty International Publications 2010

Indeksi: EUR 11/004/2010
Gjuha origjinale: Anglisht
Printuar nga Amnesty International,
Sekretariati Ndërkombëtar, Mbretëria e Bashkuar.

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Ky botim mbrohet nga e drejta e autorit, por mund të riprodhohet në çdo lloj mënyre, pa asnjë lloj tarife, për qëllime avokacie, fushatash apo mësimdhënieje, por jo për ri-shitje. Mbjajtësit e të drejtës së autorit kërkojnë regjistrimin e çdo përdorimi të tillë pranë tyre, për qëllime të vlerësimit të ndikimit. Për kopjim në çfarëdo rrethanash të tjera, ose për ri-përdorim në botime të tjera, ose për përkthimin ose përshtatjen e tij, duhet të merret leje me shkrim nga botuesit, dhe mund të aplikohet një tarifë.

Foto e kopertinës: : Konvikti i Shkollës Industriale në Shkodër. Në këtë ndërtesë banojnë jetimë të rritur dhe nxënës, 2009.

© Amnesty International

Fotot e kopertinës së pasme duke filluar nga lart: Pamje e brendshme e ndërtesës së një konvikti të rrënuar në Shkodër, ku jetojnë jetimë të rritur, 2009. © Amnesty International

Mjaftonia në konviktin e Shkollës Teknologjike në Tiranë, ku jetojnë jetimë të rritur, 2009. © Amnesty International

Në vitin 2009, Alfredi mbaroi shkollën e mesme në Shkodër dhe për muajt në vijim nuk kishte një vend të sigurt ku të banonte.

© Amnesty International

PËRMBAJTJA

Shpjegim termash.....	5
1. Hyrje	6
2. Fëmijët në përkujdes social rezidencial	11
2.1. Vendorsja në përkujdes rezidencial dhe e drejta për jetë familjare.....	11
2.2. Largimi i parakohshëm nga përkujdesi – shkelja e së drejtës për “mbrojtje dhe ndihmë të veçantë ”	12
3. E drejta për strehim të përshtatshëm dhe realiteti i të rinjve që largohen nga përkujdesi në shqipëri	15
3.1. E drejta ndërkombëtare, standardet rajonale dhe legjislacioni shqiptar	15
3.2. Konvikti si mundësi e fundit për strehim	16
4. Barrierat ndaj aksesit në strehim të përshtatshëm	19
4.1. Largimi nga përkujdesi dhe pas-kujdesi – standardet ndërkombëtare dhe realiteti	19
4.2. Kuadër i pamjaftueshëm ligjor për të rinjtë që largohen nga përkujdesi social	20
4.3. Shërbime të pamjaftueshme sociale, ligjore etj., për të rinjtë që largohen nga përkujdesi.....	21
4.4. E drejta e jetimit për strehim sipas legjislacionit kombëtar; legjislacion jo konsistent	22
4.5. Mungesa e të dhënave të sakta për nevojat e strehimit të personave të larguar nga përkujdesi social.....	23
4.6. Barrierat ndaj aksesit në strehim në tregun e lirë	24
5. Politikat e qeverisë për strehimin dhe legjislacioni për strehimin social.....	26
5.1. Dhjetëvjeçari i parë i tranzicionit (1991 deri 2001).....	26
5.2. Legjislacioni për strehimin social dhe barrierat ndaj aksesit në strehim social	27

5.3. Kriteret e përzgjedhjes për strehim social.....	27
5.4. Barrierat ndaj aksesit në strehim social me kosto të ulët.....	28
6. Forma të mundshme alternative të strehimit social	31
6.1. Strehimi social me qira – një projekt pilot.....	31
6.2. Bonuse strehimi për akomodim privat.....	32
7. Përfundime dhe Rekomandime	34
Rekomandime.....	35
Në lidhje me të drejtën për strehim të përshtatshëm.....	35
Në lidhje me të drejtat e fëmijëve pa kujdes prindëror për mbrojtje të veçantë	37
Në lidhje me largimin nga përkujdesi	37
Shënime.....	39

SHPJEGIM TERMASH

Jetim: Fjala "jetim" në shqipe përdoret me disa kuptime. Një fëmijë quhet jetim kur i kanë vdekur të dy prindërit, ose njëri prind, sidomos kur prindi i vdekur është babai (shpesh, i vetmi person që fitonte jetesën e familjes). Përveç kësaj, në përdorimin bisedor, të gjithë fëmijët që jetojnë në jetimoret shtetërore (Shtëpitë e Fëmijës) ose në institucione private që ofrojnë përkujdes rezidenciale, quhen në përgjithësi jetimë (dhe shpesh e quajnë edhe veten jetimë) ndonëse termi më i saktë do të ishte "fëmijë të privuar përkohësisht ose përgjithmonë nga kujdesi prindëror". Sot, shumica e këtyre fëmijëve kanë një ose të dy prindërit gjallë, të cilët për arsye të ndryshme, nuk mundin, ose nuk duan të kujdesen për ta, përkohësisht ose përgjithmonë. Fëmijët të cilëve u kanë vdekur të dy prindërit (ndonjëherë të njohur me termin "jetimë biologjikë"), zakonisht birësohen.

Përveç kësaj, në përdorimin e përditshëm bisedor dhe në terminologjinë ligjore, "jetimi" nuk është domosdoshmërisht person i mitur (nën 18 vjeç), por mund të jetë edhe i rritur. Legjislacioni shqiptar e njeh statusin e jetimit dhe ofron disa të drejta, ndër të cilat e drejta e trajtimit me përparësi në strehim për personat që e kanë këtë status, dhe që janë nën 25 vjeç (në disa rrethana, edhe pas kësaj moshe). Statusi i jetimit dhe të drejtat që rrjedhin prej tij nuk u ofrohen fëmijëve që kanë një ose të dy prindërit gjallë, përveç rastit kur këtyre të fundit ua ka hequr gjykata të drejtën prindërore, ose kur e kanë braktisur fëmijën.

Për qëllimet e këtij raporti, Amnesty International, në përgjithësi dhe sipas rastit konkret, përdor termat "fëmijë në përkujdes social/në strukturat e përkujdesit social," "persona të larguar nga përkujdesi social", dhe "të rinj që largohen nga përkujdesi social". Të rriturit që kanë statusin e jetimit quhen me emrin "persona me statusin e jetimit". Megjithatë, kur citohet nga shkrimet ose thëniet e shqiptarëve, është mbajtur fjala "jetim" në kuptimin e gjerë bisedor.

Së fundi, në raportin e vitit 2007 Amnesty International ka përdorur shprehjen "jetimë të rritur" për ata që ishin rritur në strukturat shtetërore të përkujdesit social dhe të cilët, për shkak të mohimit të të drejtës për strehim të përshtatshëm, banonin në ndërtesa shkollore gjysmë të rrënuara, shpesh për vite të tëra. Disa prej tyre sot kanë familje dhe po rrisin fëmijët e tyre, por jo të gjithë kanë statusin e jetimit. Për hir të njëtrajtësisë (dhe ekonomisë së shprehjes), dhe aty ku mendimi është i qartë, ky grup njerëzish quhet me të njëjtin term edhe në këtë raport, në vend të përshkrimit më të saktë të kësaj kategorie ("të rritur të pastrehë që e kanë kaluar fëmijërinë në strukturat e përkujdesit social").

Me **konvikt** në kontekstin e këtij raporti kuptohen konviktet e shkollave të mesme. Është fjala për konviktet që përdoren nga nxënësit e tanishëm të shkollave të mesme, por edhe për ato ndërtesa, ose pjesë ndërtesash, zakonisht në gjendje shumë të keqe, që janë caktuar enkas për përdorim nga jetimët e rritur që janë të pastrehë.

Persona të pastrehë: Termi "persona të pastrehë" përfshin, ndër kategori të tjera, ata që jetojnë në lloje të ndryshme strehimi të papërshtatshëm. Sipas legjislacionit shqiptar (Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 29.1.1993), ky term përfshin personat që jetojnë përkohësisht në ndërtesa që nuk bëjnë pjesë në fondin e banesave rezidenciale, siç janë konviktet e shkollave ose ndërtesa të tjera shkollore, apo njerëzit që jetojnë nëpër bodrume ose mjedise pa kushte të përshtatshme sanitare. Përveç kësaj, edhe ata që banojnë në banesa që kanë qenë dikur pronë private, por që u shtetëzuan gjatë regjimit komunist (dhe do t'u kthehen pronarëve të mëparshëm), gjithashtu klasifikohen si të pastrehë.

1. HYRJE

E drejta për strehim të përshtatshëm garantohet në legjislacionin ndërkombëtar si një e drejtë *“me rëndësi shumë të madhe për të gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore”*.¹ Mohimi i kësaj të drejte godet veçanërisht rëndë anëtarët më të cenusur në shoqërisë. Të rriturit që e kanë kaluar fëmijërinë e tyre në institucionet e përkujdesit në Shqipëri, janë një prej këtyre grupeve.

Ky raport është pjesë e fushatës *“Kërkojmë Dignitet!”* (Demand Dignity) të Amnesty International, që synon t’u japë fund shkeljeve të të drejtave të njeriut që shkaktojnë dhe thellojnë varfërinë në shkallë botërore.

Varfëria është një prej arsyeve kryesore për vendosjen e fëmijëve në strukturat e përkujdesit social në Shqipëri, dhe shteti bën pak për t’i ndihmuar ata të dalin nga varfëria. Mungesa e mbrojtjes së mjaftueshme nga shteti të të drejtave të tyre, dhe sidomos fakti që shteti nuk u jep të rinjve që largohen nga përkujdesi social mbështetjen që iu duhet atyre për të kaluar në jetë të pavarur, ka pasoja të parashikueshme. Shumë prej tyre kanë nota të dobëta në mësim ose e lënë shkollën pa fituar aftësitë dhe kualifikimet që do t’u bënin të mundur të jetonin të pavarur. Kur rriten, ata ka gjasa të mbeten të pastrehë dhe të rrezikohen nga varfëria e skajshme e përjashtimi shoqëror.

Personat që largohen nga përkujdesi – kurthi i varfërisë

A.-në, që sapo i ka kaluar të 20-tat, e çuan në shtëpinë e fëmijës në Shkodër, së bashku me motrën dhe vëllanë, kur ishte tre vjeç, pasi prindërit e tyre u ndanë dhe i braktisën fëmijët. Pasi përfundoi arsimin e detyruar tetëvjeçar, e dërguan në Shkollën Pyjore, një shkollë e mesme me konvikt. Sipas fjalëve të tij *“Nuk më bënë asnjë përgatitje për largimin nga Shtëpia e Fëmijës. Një ditë, kur u ktheva nga shkolla, më thanë që duhet të ikja. Asnjëherë nuk më pyetën nëse më pëlqente të shkoja në Shkollën Pyjore, thjesht më çuan atje. Sekretarja e shtëpisë së fëmijës më tregoi ku do të shkoja...”* Në qershor 2009, kur e takoi Amnesty International, ai sapo kishte përfunduar shkollën e mesme dhe vazhdonte të banonte në një dhomë të konviktit të shkollës, së bashku me vëllanë dhe disa të rinj të tjerë të larguar nga përkujdesi. Ai do të donte të vazhdonte universitetin, por tha se nuk i kishte notat edhe aq të mira. Ai shpjegoi: *“Kam gjetur një punë dhe sot ishte dita e parë, si marangoz. ... Sigurim nuk e di në më paguajnë, se është biznes i vogël. Nuk kam kontratë. Më paguajnë 500 lekë në ditë, nuk është e mjaftueshme për të jetuar vetë me qira...”*² Ai kishte frikë se në shtator, me ardhjen e nxënësve të rinj, do t’i duhej të ikte nga konvikti dhe se i vetmi strehim i mundshëm për të do të ishte një ndërtesë shkolle e rrënuar, aty afër, ku një kat ishte dhënë për të strehuar një grup jetimësh të rritur të pastrehë, disa prej tyre tashmë në moshë të mesme.

A., që ka statusin e jetimit, ka jetuar në Shkodër që nga moshë tre vjeçare, por është i regjistruar gjetkë, në vendin e lindjes, me të cilin ka shumë pak lidhje dhe ku mundësitë e punësimit për të janë shumë të pakta. Ngaqë nuk ishte i regjistruar në Shkodër, ai nuk përmbushte kushtet për të kërkuar punë tek zyra e punës atje, e as të bënte kërkesë për strehim social; po kështu, as nuk mund të merrte asistencë ekonomike nga shteti. Për të bërë pasaportizimin në një vendbanim të ri, ai duhet të merrte me qira një apartament (gjë që nuk kishte mundësi ta bënte) dhe të paraqiste kontratën e qirasë, të nënshkruar. Atij do t’i pëlqente të banonte në Tiranë, ku mendon se ka mundësi më të mëdha. *“Pata rastin të punoj në një hotel në Tiranë, aty saja dhe flija, por kur i thashë se isha jetim, pronari ndërroi mendje.”*

Në vitin 2007, Amnesty International botoi një raport, *Shqipëria: 'Pa shtëpi, pa jetë - jetimët dhe e drejta për strehim*.³ Ky raport shqyrtoi se si mosmbrojtja e duhur nga shteti e të drejtave të fëmijëve në përkujdes shtetëror në Shqipëri, zakonisht shkaktonte keqësim të mëtejshëm të marginalizimit të tyre kur rriteshin. Ai u përqendrua tek gjendja e jetimëve të rritur, disa prej tyre 40 vjeç e lart, që ende banonin në dhoma me të tjerë, shpesh në konvikte shkollore gjysmë të shkatërruara. Ai ballafaqonte të drejtën e tyre për strehim të përshtatshëm sipas të drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar, me kushtet e mjerueshme në të cilat jetonin, dhe tregoi se si mohimi i kësaj të drejte ndikonte aksesin e tyre në të drejtat e tjera, duke i zhytur më thellë në varfëri dhe përjashtim shoqëror.

Raporti vuri në dukje se në vitin 2006, në Shqipëri kishte më se 45000 familje të regjistruara të pastreha dhe shqyrtoi politikën e strehimit social: në vitin 2005 qeveria miratoi një program që parashikonte ndërtimin e 4000 apartamenteve, për t'u blerë nga familje me të ardhura të ulëta ose familje në nevojë, deri në vitin 2010. Në vitin 2007, qeveria siguroi edhe fonde ndërkombëtare shtesë për të ndihmuar me ndërtimin e 1100 apartamenteve për t'u dhënë me qira si strehim social. Amnesty International i mirëpriti të gjitha projektet që synonin rritjen e aksesit në strehim të përshtatshëm për të varfrit dhe njerëzit e pafavorizuar, por ishte e shqetësuar se nga këto programe do të përfitonin vetëm një pakicë e vogël njerëzish në nevojë. Ai u bëri thirrje organeve qendrore dhe vendore, si dhe donatorëve ndërkombëtarë, që të siguronin se ndërtimi dhe shpërndarja e strehimit social do të bëhej në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente. Ai bëri thirrje sidomos që gjendja veçanërisht e vështirë e të rriturve që kanë jetuar në institucione të përkujdesit social, të pasqyrohej siç duhet në çdo sistem të përcaktimit të përparësive. Ai kërkoi ndërmarrjen e veprimeve efektive për të siguruar plotësimin e të drejtës së tyre për strehim të përshtatshëm.

Amnesty International e vizitoi përsëri Shqipërinë në vitet 2008 dhe 2009. Gjatë hulumtimeve, përfaqësuesit e Amnesty International biseduan me rreth 20 të rinj 15 deri 24 vjeç, të rritur në Shtëpitë e Fëmijës, që tashmë ishin në shkollë të mesme (ose e kishin mbaruar atë). Përfaqësuesit e Amnesty International u takuan edhe me zyrtarë qeveritarë në nivel qendror dhe vendor, me drejtorët e tri Shtëpive shtetërore të Fëmijës për fëmijët nga 6 deri 15 vjeç, me personelin e konvikteve të shkollave, si dhe me organizatat jo qeveritare (OJQ) që punojnë me jetimët dhe fëmijët e tjerë pa përkujdes prindëror (gjithsej mbi 40 takime të tilla).⁴

Që nga ai raport i parë i Amnesty International kanë kaluar më se dy vjet, por gjendja e jetimëve të rritur të pastrehë, subjekti i raportit të parë, pothuaj nuk ka ndryshuar aspak. Qeveria ende nuk i ka realizuar objektivat për ndërtimin e banesave sociale dhe, sipas statistikave zyrtare që iu dhanë Amnesty-s në qershor 2009, asnjë person me status jetimi nuk kishte marrë banesë sociale që nga viti 2005. Ndërkohë, të rinjtë që largohen sot nga përkujdesi social, rrezikojnë të ndjekin të njëjtën rrugë të brezave pararendës, drejt varfërisë dhe marginalizimit.

Si rezultat i hulumtimeve të veta, në nëntor 2009, Amnesty International i dërgoi qeverisë shqiptare një memorandum, *Jetimët dhe fëmijët e tjerë pa kujdes prindëror - shqetësimet e Amnesty International*.⁵ Amnesty International tërhoqi vëmendjen se: "*Sipas së drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit vendas, fëmijët që mbeten përkohësisht apo përgjithmonë pa kujdes prindëror, kanë të drejtën e mbrojtjes dhe ndihmës së veçantë nga shteti. Ata jo vetëm që janë qytetarë të shtetit shqiptar, por edhe janë, në një kuptim shumë real, 'fëmijë*

të shtetit', për të cilët ai ka detyrimin e veçantë të përkujdesit." Memorandumi mbështetej në standardet e Projekt-Udhëzimeve të OKB-së për Përkujdesin Alternativ për Fëmijët (Udhëzimet) që u miratuan pak më vonë nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.⁶ Ai nuk synonte të ishte një trajtim shteruese i çështjeve që lidhen me fëmijët në përkujdes alternativ ose që rrezikoheshin të bëheshin të tillë, por përqendrohej më së shumti në tri fusha kryesore që përbënin shqetësim.

E para ishte se fëmijët vazhdonin të vendoseshin në institucione rezidenciale për shkak të varfërisë së familjes. Amnesty International bëri thirrje për një mbështetje më të madhe financiare dhe shoqërore për familjet që rrezikoheshin të hiqnin dorë nga fëmija i tyre; organizata gjithashtu bëri thirrje për ndryshime në rregullat e pranimit në institucionet rezidenciale, për të siguruar që fëmijët të mos futen në këto institucione vetëm për shkak të varfërisë familjare, por vetëm kur institucionalizimi është në interesin më të mirë të fëmijës.

Shqetësimi i dytë ishte se niveli i përkujdesit, mbikëqyrjes dhe ndjekjes së mëtejshme të fëmijëve që largohen nga Shtëpitë shtetërore të Fëmijës, është i pamjaftueshëm; në veçanti, fëmijët e dërguar në shkolla profesionale me konvikt nuk marrin mbrojtjen dhe asistencën e duhur nga shteti deri në arritjen e moshës madhore (18 vjeç), siç u takon sipas të drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit vendas. Kjo lënie pas dore pasqyrohet në rezultatet e ulëta arsimore dhe mungesën e përgatitjes për jetë të pavarur, e cila, nga ana e vet, dëmton perspektivat e punësimit të tyre në të ardhmen, si dhe mundësitë e tyre për të siguruar strehim të përshtatshëm.

Së treti, Amnesty International tërhoqi vëmendjen për mungesën e një legjislacioni gjithëpërfshirës mbi largimin nga përkujdesi, dhe për moszbatimin e legjislacionit ekzistues (sidomos, të së drejtës së personave me statusin e jetimit për trajtim me përparësi në strehim dhe punësim). Kjo rëndohet edhe nga mungesa e strukturave komunitare që ofrojnë shërbime ligjore, sociale, etj., për rinjtë, kur këta largohen nga përkujdesi dhe kalojnë në jetë të pavarur.

Amnesty International vuri në dukje se Strategjia Kombëtare për Fëmijë (2005-2010) dhe Plani i Veprimit i lidhur me të, miratuan nga qeveria shqiptare në vitin 2005, parashtrojnë politika që, në shumë drejtime, i përgjigjen këtyre shqetësimeve; por, vullneti politik për t'i zbatuar këto politika ka qenë i pamjaftueshëm.⁷ Memorandumi bëri një numër rekomandimesh për marrjen e masave legjislative dhe praktike që rrjedhin nga standardet e Udhëzimeve, dhe e ftoi qeverinë t'u përgjigjet atyre. Më 1 shkurt 2010 Presidenti Bamir Topi, në përgjigjen e tij, siguroi se shqetësimet dhe rekomandimet e Amnesty International po ndiqeshin me vëmendjen e duhur nga institucionet përgjegjëse shqiptare, të cilat po përgatisin ndryshimet përkatëse në legjislacionin shqiptar. Ai shprehu mbështetjen e tij për këtë proces dhe përmendi hartimin e një ligji që mbron të drejtat e fëmijëve. Amnesty International ende nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ndonjë anëtar i qeverisë për Memorandumin e saj.

Raporti i tanishëm ndjek në vijimësi raportin e Amnesty International të vitit 2007. Ai gjithashtu mbarë shqetësimet e Memorandumit për të drejtat e jetimëve dhe të rinjve të tjerë që largohen nga përkujdesi shtetëror. Ai shqyrton sidomos barrierat që i pengojnë ata të kenë akses në strehim të përshtatshëm, duke mos u lënë rrugë tjetër përveçse të bashkohen me paraardhësit e tyre në ndërtesa të vjetra, me kushte të mjera, të konvikteve gjysmë të

rrënuara të shkollave. Ndër këto barrierat përfshihen mungesa e një legjislacioni gjithëpërfshirës që trajton të larguarit nga përkujdesi, përmendur më sipër, dhe shërbimet e pamjaftueshme sociale për t'i mbështetur ata në sigurimin e strehimit. Politikat qeveritare parashikojnë futjen e programeve të veçanta për t'i përgatitur jetimët për jetë të pavarur kur largohen nga institucionet, por ende nuk është ndërmarrë asnjë veprim për ta arritur këtë qëllim.

Shumë të rinj që largohen nga përkujdesi kanë kapacitet të ulët të fitimit të të ardhurave, që do të thotë se vetëm pak prej tyre mund ta përballojnë strehimin në tregun e hapur, ku banesat me qira janë të pakta dhe shumë të kushtueshme. Kjo nuk është e vërtetë vetëm për të rinjtë që largohen nga përkujdesi social shtetëror, por edhe për shumë prej atyre që largohen nga institucionet private, kur asistenca financiare fillestare për pagimin e qirasë, që ua japin këto institucione, ndërpritet.

Ndonëse barrierat për qasje në strehim privat janë shumë të mëdha, edhe më të mëdha janë kufizimet në mundësitë për strehim social. Numri i banesave sociale vazhdon të jetë shumë i vogël dhe numri i familjeve të regjistruara të pastreha mbetet i lartë (mbi 40000 në vitin 2008). Politika qeveritare për strehimin ka favorizuar programet e strehimit social, sipas të cilëve shteti ndërton (ose blen) banesa me kosto të ulët, të cilat pastaj blihen nga aplikantët me kredi të subvencionuara nga shteti. Pasi nuk u arrit objektivi fillestar për 4000 apartamente të tilla, në vitin 2008 qeveria paraqiti një skemë, sipas së cilës rreth 3000 aplikantë mund të blinin banesë (me disa kufizime në çmim) në tregun e hapur. Por qëllimi kryesor i kësaj skeme është t'u kthejë ish pronarëve pronat e tyre. Nivelet e të ardhurave dhe kriteret e tjera të përzgjedhjes për këtë skemë përjashtojnë ata që janë vërtet të varfër dhe në nevojë. E vetmja shpresë që u mbetet është një program strehimi social me qira, ndërkohë që 1100 apartamentet e përmendura më sipër ende nuk janë përfunduar.

Legjislacioni shqiptar e njeht pozitën e cënueshme të jetimëve dhe u garanton atyre përparësi në strehim. Megjithatë dispozitat ligjore nuk janë konsistente; ato duket se nxisin aspiratën për pronësi të banesës, por politika e tanishme e strehimit social e bën këtë të paarrtshme për shumicën e jetimëve. Ato janë edhe diskriminuese, në kuptimin që përkufizimin ligjor i fjalës “jetim” (siç shpjegohet më poshtë), nuk përfshin të rinjtë që largohen nga përkujdesi që kanë një ose dy prindër gjallë, të cilët mbajnë me ta kontakte minimale, por që nuk munden, ose nuk duan, t'u ofrojnë strehë ose ndonjë mbështetje tjetër. Ndonjëherë të quajtur “jetimë socialë”, nevojat e ngutshme për strehim të këtyre të rinjve në Shqipëri janë shpesh të ngjashme me ato të personave që plotësojnë kriteret ligjore të “statusit të jetimit.” Së fundi, dhe me rëndësi thelbësore, e drejta e përparësisë në strehim është zbatuar vetëm në raste jashtëzakonisht të veçanta. Sipas statistikave zyrtare, vetëm 29 nga 845 personat me statusin e jetimit kanë përfunduar strehim social, dhe asnjë prej tyre që nga viti 2005 e këtej.

Në përfundim, Amnesty International u bën thirrje autoriteteve shqiptare të miratojnë një legjislacion gjithëpërfshirës mbi largimin nga përkujdesi social, i cili mbështet të gjithë personat që largohen nga përkujdesi në kalimin drejt pavarësisë dhe në periudhën e pas-kujdesit. Në të duhet të përfshihen dispozita që sigurojnë arsimimin dhe përgatitjen e duhur, shumë përpara se të largohen nga përkujdesi institucional dhe për një periudhë të mjaftueshme të mëtejshme, si dhe ndihmën për gjetjen e punësimit dhe një qasje efektive në strehim të përshtatshëm. Vetëm kështu mund të ndalen proceset e përjashtimit shoqëror dhe

varfërisë së skajshme dhe të rinjtë e cenueshëm mund të hyjnë në rrugën e një jete të qëndrueshme dhe të pavarur.

Qeveria duhet të marrë gjithashtu masa efektive për të vënë në vend dëmin e shkaktuar nga mosplotësimi i detyrimeve të saj kundrejt të drejtës për strehim dhe punësim të përshtatshëm të brezave të mëparshëm të rritur në përkujdes social. Këta njerëz përjetuan vitet më të trazuarat e të vështira të tranzicionit. Tani ata janë në moshë të pjekur dhe, disa prej tyre, po rrisin fëmijët me vështirësi të mëdha, në kushte jetese dhe banimi krejt të papërshtatshme.

Problemi i mungesës së banesave sociale nuk mund të zgjidhet menjëherë. Megjithatë e drejta ndërkombëtare njih faktin se të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore nuk mund të realizohen plotësisht menjëherë, shteteve palë u kërkohet të përdorin maksimumin e burimeve në dispozicion, si të atyre të brendshme, ashtu edhe të atyre që janë të disponueshme nëpërmjet ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, për të vepruar sa më shpejt dhe sa më efektivisht për përbushjen e plotë të këtyre të drejtave, përfshirë të drejtën për strehim, pavarësisht shtimit të burimeve të disponueshme.⁸

Duke e ditur që projektet e tanishme të strehimit social do të plotësojnë vetëm nevojat e një pakice të vogël të pastrehësh në Shqipëri, dhe në pritje të krijimit të një fondi të mjaftueshëm banesash sociale, Amnesty International argumenton se duhet të merren në shqyrtim mjete alternative për të garantuar të drejtën e jetimëve dhe personave të tjerë që largohen nga përkujdesi për strehim të përshtatshëm. Siç është vënë në dukje, qeveria ka vënë në zbatim një skemë e cila u mundëson atyre që duan të blejnë banesa sociale, që t'i marrin ato në tregun e hapur. Sipas mendimit të Amnesty International, shtimi i fondeve shtetërore për subvencionimin e qirave për strehim privat, një mundësi që parashikohet edhe në ligj, është një alternativë e mundshme për t'u vënë në dispozicion banesa të përshtatshme të varfërve dhe të pafavorizuarve, përfshirë jetimët dhe personat e tjerë që largohen nga përkujdesi. Ka edhe rrugë të tjera për ta shtuar fondin e banesave sociale. Kohët e fundit, në fillim të prillit 2010, Kryetari i Bashkisë së Durrësit ka shpallur se lejet e ndërimit në bashkinë e Durrësit do të jepen me kusht që një pjesë (3%) e ndërtesës t'i jepet bashkisë për përdorim si banesa sociale.⁹ Kjo nismë e vlen të shqyrtohet edhe nga bashki të tjera.

Politikanë të njohur të të gjitha partive kryesore kanë shprehur shumë herë qëllimin e tyre për t'i ndihmuar më shumë jetimët. Më 20 maj 2009, në Ditën Kombëtare të jetimëve, dhe një muaj para zgjedhjeve kombëtare, Ilir Meta, udhëheqësi i Lëvizjes Socialiste për Integrim, sot Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme u është drejtuar kështu jetimëve të Shqipërisë:

“Unë dua të siguroj, që do bëj gjithçka që është e mundur, pasi mundësitë janë pafund kur ekziston vullneti i shtetit dhe i Qeverisë për të lehtësuar jetën tuaj, për të krijuar të gjitha mundësitë për t'u arsimuar dhe për t'u shkolluar në mënyrë të denjë, për të pasur mundësi për t'u punësuar dhe njëkohësisht për strehim që ngelet një problem kyç, i cili nuk mund të zgjidhet pa marrë përsipër shteti dhe Qeveria kredi me interesa të ulëta dhe afatgjata, në mënyrë që secili të ketë mundësi të krijojë familjen e tij.”¹⁰

Shumë jetimë, ndër të tjerë, po presin plotësimin e këtij premtimi dhe të premtimeve të tjera të ngjashme.

2. FËMIJËT NË PËRKUJDES SOCIAL REZIDENCIAL¹¹

Shqipëria vazhdon të jetë një nga vendet më të varfra në Evropë. Pavarësisht nga rritja ekonomike, shumë njerëz jetojnë në varfëri, papunësi dhe pa strehë.¹² Njëzet vjet pas rënies së regjimit komunist, Shqipëria vazhdon të vuajë nga ndasitë e thella politike dhe nga tensionet shoqërore, që rrjedhin nga ndryshimi i shpejtë drejt demokracisë shumë-partiake dhe ekonomisë së tregut. Në këtë sfond, ndonëse me vështirësitë e veta, familja është mbështetja dhe streha kryesore në jetën e shumë njerëzve. Për këtë arsye, jetimët dhe të rinjtë e tjerë të rritur në përkujdes rezidencial, janë ndër grupet më të pafavorizuara: atyre u mungon mbështetja dhe streha e vatrës familjare, rrjeti familjar përmes të cilit fëmijët dhe të rinjtë gjejnë vendin e tyre në komunitetin më të gjerë dhe i cili, më vonë, mund t'i ndihmojë të gjejnë punë dhe të krijojnë familjet e tyre.

Megjithatë, pozita e rrezikuar këtyre të rinjve dhe vështirësitë që përjetojnë, të cilat i lënë të papërgatitur për sfidat e jetës si të rritur dhe pengojnë qasjen e tyre në strehim dhe punësim, nuk është thjesht “rastësi ose ‘punë fati’”. Ajo vjen edhe sepse shteti nuk i ka zbatuar detyrimet e veta sipas të drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit vendas. Ndër to është shkëlqja e të drejtës së tyre për jetë familjare, për “mbrojtje dhe ndihmë të veçantë” nga shteti (si fëmijë pa kujdes prindëror), dhe për arsim. Këto janë të sanksionuara në të drejtën ndërkombëtare, sidomos në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992. Kohët e fundit, Udhëzimet e OKB-Së për Kujdesin Alternativ për Fëmijët (Udhëzimet), të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 18 dhjetor 2009, kanë vendosur standardet ndërkombëtare për kujdesin për fëmijët pa kujdes prindëror.¹³

2.1. VENDOSJA NË PËRKUJDES REZIDENCIAL DHE E DREJTA PËR JETË FAMILJARE

Familjet shqiptare nuk ia japin lehtë fëmijët përkujdesit institucional; modeli më mbizotërues dhe më i përhapur i përkujdesit alternativ për fëmijët në Shqipëri është ai jo-formal, nga gjyshërit ose të afërmit e tjerë. Numri i fëmijëve në përkujdesin e institucioneve rezidenciale mbetet i ulët krahasuar me standardet rajonale.¹⁴

Jetimoret shtetërore (Shtëpitë e Fëmijës) kujdesen për fëmijët deri në moshën 15 vjeç dhe organizohen në bazë grupmoshe (0-3, 3-6, 6-15 vjeç). Sipas këtij sistemi, fëmijët mund të lëvizin disa herë deri në moshën 15 vjeçare, gjë që çon në shkëputje të marrëdhënieve me personelin dhe fëmijët e tjerë, si dhe me vëllezërit dhe motrat që bëjnë pjesë në grupmosha të tjera. Shumica e Shtëpive shtetërore të Fëmijës sot janë përgjegjësi e organeve vendore, por i nënshtrohen inspektimeve nga qeveria qendrore (Shërbimi Social Shtetëror). Në fund të vitit 2008, sipas Shërbimit Social Shtetëror, në këto institucione kishte 241 fëmijë.

Ka edhe fëmijë të tjerë, përkujdesi i të cilëve bëhet në institucione private, të drejtuara nga OJQ dhe fondacione fetare të licencuara nga shteti. Në to, fëmijët rriten në shtëpi të tipit familjar – që shpesh quhen “Casa Famiglia” – ku grupe të vogla fëmijësh të moshave të ndryshme jetojnë së bashku me një kujdestar, vëllezërit e motrat nuk ndahen, dhe nxitet krijimi i marrëdhënieve të tipit familjar me kujdestarin/kujdestaren dhe me fëmijët e tjerë në grup.¹⁵ Sipas të dhënave, në fund të vitit 2008 numri i tyre ishte 362.¹⁶

E përbashkëta e shumë prej këtyre fëmijëve, si në institucionet shtetërore ashtu edhe në ato

private, është se, në më të shumtën e rasteve, shkak kryesor i vendosjes së tyre në strukturat e përkujdesit është varfëria, që shpesh vjen nga prishja e martesave ose familjeve një-prindërore.¹⁷ Këshillimi social dhe ligjor për familjet, përveç atij që ofrohet nga disa OJQ, është shumë i paktë, ndërsa ndihma ekonomike shtetërore për familjet është e pamjaftueshme: në vitin 2009 ndihma maksimale ekonomike ishte 7500 lekë në muaj.¹⁸

Varfëria në vetvete nuk duhet të jetë arsye për ta vendosur fëmijën në strukturat e përkujdesit social. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës deklaron parimin drejtues se familja është *“grupi bazë i shoqërisë dhe mjedisi i natyrshëm për rritjen dhe mirëqenien e gjithë anëtarëve të saj dhe sidomos të fëmijëve”*. Sipas kësaj konvente, shteteve u kërkohet *“t’u japin ndihmën e duhur prindërve dhe kujdestarëve ligjorë në kryerjen e përgjegjësive të tyre për rritjen e fëmijëve ...”*.¹⁹ Në mars 2005, Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijës, një komitet ekspertësh të pavarur që mbikëqyr zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës u shpreh se *“vazhdon[te] të ishte i shqetësuar se fëmijët mund të ... vendoseshin nëpër institucione nga prindër në gjendje të vështirë ekonomike”*, dhe i rekomandonte Shqipërisë marrjen e masave për të dhënë mbështetjen e duhur, e cila do t’u mundësonte familjeve të kujdeseshin për fëmijët e tyre në shtëpi.²⁰ Ndonëse politika e shpallur e qeverisë që nga viti 2005 ka qenë pakësimi i numrit të fëmijëve në strukturat e përkujdesit duke i ndihmuar familjet të kujdesen për fëmijët në shtëpi, pak është bërë për ta zbatuar këtë rekomandim. Përkundrazi, një vit më vonë, qeveria shqiptare, në një vendim për kategoritë e fëmijëve që mund të pranohen në institucionet e përkujdesit rezidencial, përfshinte edhe *“fëmijë, prindërit e të cilëve nuk kanë burimet e mjaftueshme financiare për të mbajtur fëmijën”*.²¹

Në qershor 2009 një djalë 16 vjeçar, që e kishte lënë Shtëpinë e Fëmijës një vit më parë, nxënës në një shkollë profesionale me konvikt, i foli me shumë hidhërim Amnesty International se si e kishin vendosur në përkujdes. Siç tregonte ai, pas braktisjes së babait, nëna nuk ishte në gjendje ta mbante familjen. Si pasojë, atë dhe dy vëllezërit i kishin çuar në Shtëpinë e Fëmijës: *“Nëna mundohet të na mbledhë të gjithë së bashku tri herë në vit dhe të krijojë ndjenjën e një familjeje. Hyn në borxh për të na dhënë pak gëzim. Ajo nuk donte të na çonte në jetimore.”*

2.2. LARGIMI I PARAKOHSHËM NGA PËRKUJDESI – SHKELJA E SË DREJTËS PËR “MBROJTJE DHE NDIHMË TË VEÇANTË ”

Fëmijët e Shtëpive shtetërore të Fëmijës largohen prej tyre pas mbarimit të arsimit nëntëvjeçar rreth moshës 15 vjeç. Ligji shqiptar kërkon që, para largimit, ata të pyeten se ç’duan të bëjnë në të ardhmen, dhe të këshillohen për rreziqet e shfrytëzimit, shëndetin seksual, abuzimin e drogës dhe alkoolit, si dhe t’u jepen udhëzime praktike për menaxhimin e parave, pastrimin dhe gatimin. Ekziston gjithashtu edhe kërkesa që fëmija të përkrahet edhe pas largimit nga përkujdesi, por nuk bëhet asnjë specifikim se kush është përgjegjës për këtë, ose për kohëzgjatjen e kësaj mbikëqyrjeje dhe përkrahjeje të mëtejshme.²² Disa fëmijë kthehen tek familjet ose të afërmit e tyre; disa të tjerë kalojnë nën përkujdesin e OJQ-ve. Pjesa tjetër transferohen në shkolla të mesme profesionale me konvikt, nëpër qytete, ku strehohen së bashku me të rinj të tjerë që bëjnë shkollën larg familjes.

Megjithatë, zgjedhja e shkollës mund të mos pasqyrojë dhe aq nivelin arsimor, aftësitë dhe interesat e fëmijës, se sa ekzistencën e vendeve të lira në një konvikt, si dhe faktin që ka shumë pak mundësi të tjera alternative për fëmijët që ende nuk janë gati të shkojnë në

shkollë të mesme ose të cilëve nuk u përshtatet arsimit i mesëm. Sipas u shpreh një psikologe, në jetimoren ku punonte ajo, shumica e fëmijëve mezi e mbaronin dot edhe arsimin nëntëvjeçar, *“por shpesh i dërgojmë në shkollë të mesme për t’ua zgjatur strehimin dhe ushqimin.”*²³ Komenti i saj tregon nevojën për një ndihmë më të madhe arsimore për fëmijët që mund të kenë zhvillim të vonuar për shkak të vështirësive ose traumave të përjetuara.

Në këto shkolla, fëmijët nga jetimoret shtetërore akomodohen në konvikte, arsimohen dhe ushqehen falas, marrin një shumë të vogël parash për *veshmbathje* (10000 lekë për një vit) dhe një shumë nominale mujore prej 200 lekësh për shpenzime vetjake.²⁴

Por, në fakt, ata po largohen para kohe nga përkujdesi. Sipas Nenit 20 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës: *“Fëmijët e privuar përkohësisht ose përgjithmonë nga mjedisi i tyre familjar, ose kur është në interesin më të mirë të tyre të mos lejohen të qëndrojnë në atë mjedis, kanë të drejtën e mbrojtjes dhe ndihmës së veçantë të dhënë nga Shteti”*. Ndonëse u plotëson nevojat ekzistenciale, shteti nuk ua jep këtë “mbrojtje dhe ndihmë të veçantë”, e drejtë që u buron edhe nga legjislacioni shqiptar si të mitur pa kujdes prindëror (Nenet 54 dhe 59.1e të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).²⁵ Një aspekt i mungesës së kësaj “mbrojtjeje dhe ndihme të veçantë” pasqyrohet në faktin se ata nuk kanë më një kujdestar ligjor dhe se nuk kanë ndonjë organ shtetëror apo të rritur që caktohet t’u japë përkujdes të posaçëm individual.²⁶

Për më tepër, niveli i mbështetjes individuale dhe i mbikëqyrjes arsimore që ofrohet është i pamjaftueshëm për këta adoleshentë shpesh të trazuar, dhe nuk u siguron të drejtën e një arsimit që zhvillon *“potencialin e plotë të personalitetit, talenteve dhe aftësive mendore dhe fizike të tyre”*, siç kërkohet nga Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.²⁷ Neglizhimi i tyre vihet re edhe në mungesën e politikave dhe procedurave që i përgatisin për jetë të pavarur dhe për kalimin drejt pavarësisë. Si pasojë e kësaj shpërfilljeje, jetimët dhe të rinjtë e tjerë pa kujdes prindëror që dërgohen në shkolla profesionale me konvikt, shpesh marrin nota të dobëta ose nuk e kalojnë klasën, dhe rrezikohen të rrëshqasin në botën e krimit ose të bëhen viktima të shfrytëzimit seksual. Siç shpjegohet më poshtë, me përfundimin - ose braktisjen - e shkollës, shumica janë të pastrehë dhe mund të gjejnë strehim vetëm në ndërtesa shkollore gjysmë të braktisura. Drejtori i një Shtëpie Fëmije i tha Amnesty International: *“Është e vërtetë që disa preferojnë jetën e rrugës kur hasin në vështirësi. Puna jonë humb kot kur këta fëmijë largohen nga Shtëpia e Fëmijës.”* Një vajzë që jetonte në konvikt, u shpreh: *“[Ne jetimët nëpër konvikte] kemi nevojë për këshilla, një fjalë të mirë dhe më shumë përkujdes.”*

Kjo mbështetje është e paktë. Në vend të saj, këta të rinj shpesh ndeshen me një paragjykim të përgjithësuar kundër “jetimëve”. Madje kjo ndonjëherë shihet edhe në qëndrimet zyrtare. Amnesty International ka vënë re në disa raste se zyrtarët i karakterizojnë të rinjtë nga institucionet e përkujdesit shoqëror si “problematikë”. Një zyrtar i tillë u shpreh se ata zakonisht kishin probleme me ligjin dhe “shfaqeshin në radarin e policisë”. Çka i mungon këtij perceptimi, është njohja e shkallës në të cilën ata, në shumë drejtime të tjera, janë “jashtë radarit” të shtetit. Këtë ia pranoi Amnesty International një zyrtarë e Shërbimit Social Shtetëror: *“Nuk mund të gjykohen keq këta fëmijë nëse përfundojnë keq. Ata dalin nga institucionet shtetërore ku kanë një lloj përkujdesjeje, dhe pastaj hidhen në mes të rrugës pa asnjë kujdestari. Nuk kam dëgjuar asnjëherë të flitet për strehimin apo arsimimin këtyre të rinjve. Është e qartë që mungon vullneti i palëve dhe ky grup nuk është përparësi për asnjë*

hallkë qeveritare.”

I ndërgjegjshëm se të rinjve që largohen nga Shtëpitë shtetërore të Fëmijës u nevojitet më shumë ndihmë dhe mbështetje nga sa u jepet në konvikt, Fondacioni fetar “Shpresë për Botën” (Hope for the World - SHBA) hapi në vitin 2000 qendrën TAG në Tiranë. Kjo qendër ofron akomodim, përkujdes dhe mbikëqyrje për deri në 16 nxënës të shkollave të mesme (10, në qershor 2009), meshkuj dhe femra; qendra planifikon ta rrisë kapacitetin në shtator 2010. Në vitin 2003 Madonnina del Grappa, një fondacion fetar italian, duke njohur pozitën veçanërisht të rrezikuar të vajzave të reja që largohen nga përkujdesi institucional, krijuan një “Casa Famiglia” ose shtëpi-familje për një grup të vogël, që në qershor të vitit 2009 përkujdesej për gjashtë vajza të transferuara aty nga Shtëpia e Fëmijës në Shkodër. Megjithatë, këto dy qendra kanë kapacitet të kufizuar, dhe, si të gjithë institucionet e këtij lloji, varen nga financimet e donatorëve.

Fëmijët nga institucionet private, pasi mbarojnë arsimin nëntëvjeçar, transferohen në Komunitetet Rinore ose në Apartamente të Mbrojtura. Këtu jetojnë në grupe të vogla dhe vazhdojnë të kenë mbikëqyrje personale dhe arsimore, për t’u përgatitur për një jetë të pavarur. Këtyre të rinjve u ofrohet mbështetje gjatë kalimit në jetë të pavarur dhe gjatë periudhës së pas-kujdesit, që në disa raste shkon deri në moshën 25 vjeçare. Kjo mbështetje zakonisht përfshin një ndihmë fillestare financiare për pagimin e qirasë së një banese të marrë privatisht, për gjetjen e një pune ose kryerjen e një kualifikimi të mëtejshëm, si dhe këshillim.

Ky raport përqendrohet kryesisht tek barrierat ndaj qasjes në strehim të përshtatshëm, me të cilat përballen të rinjtë që janë rritur nën përkujdesin e shtetit. Megjithatë, siç do të shihet më poshtë, ka prova se edhe të rinjtë që janë rritur në institucione private mund të hasin në vështirësi të mëdha në sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për të përballuar qiranë e banesave private dhe shpenzimet e tjera të jetesës.

3. E DREJTA PËR STREHIM TË PËRSHTATSHËM DHE REALITETI I TË RINJVE QË LARGOHEN NGA PËRKUJDESI NË SHQIPËRI

3.1. E DREJTA NDËRKOMBËTARE, STANDARDET RAJONALE DHE LEGJISLACIONI SHQIPTAR

“... e drejta për të jetuar diku në siguri, paqe dhe me dinjitet...”²⁸ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK), Komenti i Përgjithshëm 4

Shqipëria është e detyruar të zbatojë dispozitat e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, që kërkon nga shtetet të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtën për strehim të përshtatshëm dhe për të siguruar që grupet e pafavorizuara të kenë akses të plotë dhe të qëndrueshëm në burimet e përshtatshme të strehimit. Shtetet, po kështu, kanë detyrimin që t'u japin përparësi grupeve më të pafavorizuara dhe të cenueshme në politikat dhe programet qeveritare, si dhe kur bëjnë shpërndarjen e burimeve. Në veçanti, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK), e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991, parashtrohet në Nenin 11.1:

*“Shtetet-Palë në këtë Konventë njohin të drejtën e çdokujt për një standard të përshtatshëm jetese për vete dhe familjen, përfshirë ushqim, veshmbathje dhe **strehim** të përshtatshëm, si dhe për një përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të jetesës. Shtetet-Palë do të ndërmarrin hapat e duhura për të siguruar realizimin e kësaj të drejte, duke pranuar për këtë qëllim rëndësinë thelbësore të bashkëpunimit ndërkombëtar mbi bazën e një pëlqimi të lirë.”*
[theksimi i shtuar.]²⁹

Në Komentin e Përgjithshëm 4, Neni 11.1, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK), që interpreton KNDESK, ka theksuar që individët, ashtu si edhe familjet, kanë të drejtën e strehimit të përshtatshëm pavarësisht nga mosha, gjendja ekonomike, grupi, apo çdo lloj përkatësie ose statusi tjetër; përveç kësaj ai thotë se: **“Grupeve të pafavorizuara duhet t'u jepen mundësi të plota dhe të qëndrueshme për përdorimin e burimeve të përshtatshme të strehimit”** dhe se: **“Shtetet-Palë duhet t'i japin përparësinë e duhur atyre grupeve shoqërore që jetojnë në kushte të pafavorshme duke u kushtuar vëmendje të veçantë”**.³⁰ [theksimi i shtuar.]

E drejta për strehim të përshtatshëm njihet gjithashtu edhe në Kartën Sociale Evropiane të Rishikuar, e cila thekson se e drejta për strehim është një përbërës kyç i të drejtës për t'u mbrojtur nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror (Neni 30), por edhe një e drejtë e pavarur. Neni 31 thotë:

“Për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për strehim, Palët angazhohen të marrin masa që kanë për qëllim: të nxisin mundësitë për një strehim të standardeve të përshtatshme; të parandalojnë e të pakësojnë numrin të pastrehëve me qëllim eliminimin e tij gradual; ta bëjnë çmimin e strehimit të përballueshëm për njerëzit që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme”.

Shqipëria e ka ratifikuar Kartën Sociale Evropiane të Rishikuar në vitin 2002, por nuk i

konsideron Nenet 30 dhe 31 si detyruese për të.

Kushtetuta e Shqipërisë kërkon nga shteti të përmbushë nevojat për strehim të qytetarëve të vet, “brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe përgjegjësisë private” dhe të sigurojë “përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët” (Neni 59). Legjislacioni shqiptar, siç do të shihet më poshtë, garanton të drejtën e jetimëve të regjistruar për të pasur përparësi në strehim. Megjithatë, në praktikë, qeveri të njëpasnjëshme në dy dhjetëvjeçarët e fundit, i kanë shpërfillur pothuaj plotësisht detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit kombëtar për t’u siguruar strehim të përshtatshëm këtyre të rinjve shpesh të rrezikuar dhe të pafavorizuar, kur largohen nga përkujdesi social.

3.2. KONVIKTI SI MUNDËSI E FUNDIT PËR STREHIM

Në vitin 2007 Amnesty International përshkroi situatën e të rinjve dhe të rejave që ishin rritur në institucione shtetërore, të cilët pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale me konvikt, mbeteshin faktikisht të pastrehë. Organet qendrore dhe vendore të strehimit nuk u kishin siguruar strehim të përshtatshëm. Përkundrazi,, me ardhjen e nxënësve të rinj në konviktet e shkollave, ata dërgoheshin në pjesët më të lëna pas dore, gjysmë të rrënuara, të konviktit, ose në ndërtesa të tjera në gjendje po aq të shkatërruar. Amnesty International i përmbodhi kushtet e tyre të jetesës si më poshtë:

“Ndërtesat ...janë shpesh në gjendje të shkatërruar për shkak të mosriparimit. Dhomat, shpesh me shenja lagështire nëpër mure, kanë pak pajisje, përveç krevateve të vjetra dhe dollapëve të thyer. Ato nuk ofrojnë kushte për jetë private -- disa njerëz ndajnë të njëjtën dhomë. Korridorët e përbashkët, me muret e pista që u ka rënë boja, janë me lagështirë dhe të ftohtë në dimër. Ndërsa dushet dhe banjat e përbashkëta, që janë në gjendje të mjerueshme gjatë gjithë kohës, mbajnë një erë të keqe mbytëse gjatë verës dhe mund të konsiderohen si rrezik për shëndetin, sidomos për fëmijët.”³¹

Pak ka ndryshuar që nga viti 2007; “rekrutë” të rinj u janë bashkuar dhe vazhdojnë t’u bashkohen në këto kushte të mjerueshme brezave të mëparshëm të personave të larguar nga përkujdesi. Në qershor të vitit 2009, Drejtori i Përgjithshëm i konvikteve të Tiranës i shpjegoi Amnesty International: *“Jetimët që kanë mbaruar shkollën, por që vazhdojnë të trajtohen në konvikt, do të marrin bursën) deri më 15 shtator [2009]. Pas kësaj, nuk mund të hanë më në mensë, e as të marrin bursën. Nëse nuk largohen nga konvikti vetë, ne nuk i nxjerrim. Pushteti vendor duhet t’u gjejë strehim.”*

Sipas të dhënave, sot ka rreth 220 jetimë të rritur, të moshës nga 19 deri në 45 vjeç, që jetojnë në konvikte ose në ndërtesa të tjera ish-shkolla. Kushtet në to as nuk fillojnë t’u afrohen standardeve për “strehim të përshtatshëm” siç kërkohet nga KDESK-u: a) siguria ligjore e të drejtës së banimit; b) mundësia e përdorimit të shërbimeve, materialeve, lehtësive, dhe infrastrukturës; c) mundësia e përballimit financiar; d) banueshmëria; e) aksesibiliteti; f) vendndodhja dhe g) përshtatshmëria kulturore.³²

Mbi të gjitha, ato nuk përmbushin standardet e banueshmërisë të përcaktuara nga Komiteti: *“Strehimi i përshtatshëm duhet të jetë i banueshëm, në kuptimin që t’u japë banorëve hapësirë të mjaftueshme dhe t’i mbrojë nga të ftohtët, lagështira, të nxehtët, shiu, era, ose kërcënime të tjera ndaj shëndetit, nga rreziqet strukturore, dhe nga vektorët e sëmundjeve”.*³³

Vetë banorët kanë shumë pak shtysa për t'i përmirësuar këto kushte, sepse nuk kanë as sigurinë më minimale të një qëndrimi afatgjatë; madje, në fakt, në disa raste, janë kërcënuar me dëbim ose janë dërguar në ndërtesa të tjera të ngjashme. Megjithatë, për ata që jetojnë në varfëri, shpesh me të ardhura të pasigurta dhe të parregullta, fakti që kanë një strehë, sado të keqe, dhe nuk paguajnë qira, është një arsye e fuqishme për të mos u larguar. Prania e tyre shërben gjithashtu për t'u kujtuar sadopak autoriteteve detyrimet të cilat ende mbeten për t'u plotësuar.

E.-në e kishin braktisur që foshnjë dhe e kishin vendosur në Shtëpinë e Foshnjës në Vlorë. Ajo u rrit nëpër jetimore dhe ndoqi shkollën e mesme tregtare në Vlorë. Kur mbaroi shkollën e mesme, më 1995, u punësua nga shkolla si pastruese. Bashkia nuk i dha strehim, por shkolla e lejoi të qëndronte në ish ndërtesën e infirmierisë së shkollës. Kur u vizitua nga Amnesty International në qershor 2009, ajo jetonte në atë ndërtesë të vogël, ndarë në dy dhoma gjithë lagështi, bashkë me të shoqin, që nuk kishte një punë të rregullt, dhe dy vajzat e tyre. Pronësia e ndërtesës është në diskutim dhe është kërkuar nga ish-pronarët. E. po pret me anktë rezultatin e këtyre procedimeve. "17500 lekë marr në muaj si pastruese në konvikt; burri është pa punë. Kam bërë kërkesë për shtëpi dhe kam shkuar rregullisht në bashki. Më mbajnë me shpresa, unë gëzohem për momentin dhe pastaj harrohet gjithçka përsëri. Dhe unë filloj nga e para të trokas në zyra... Banesat e fundit sociale u shpërndanë dhe ...përsëri nuk fitova gjë. Më kanë thënë që të bëj privatizimin e kësaj godinës ku jam... Problemi këtu është se nuk i dihet në është pronë private apo jo, që ta di edhe unë se çfarë të bëj ... Shteti na thotë të krijojmë familjen dhe unë ja, e krijova familjen, e tani ku ta mbaj familjen?"

Aty afër, pesë jetimë të tjerë në moshë të rritur, jetojnë në një ndërtesë të rrënuar, në konviktin e dikurshëm të shkollës. Edhe çështja e pronësisë së e kësaj ndërtese është e pazgjidhur.

Si rezultat i mosveprimit nga ana e shtetit, ndërtesat e shkollës të caktuara për përdorim nga nxënësit e shkollës së mesme, kanë marrë një funksion të dytë, të papërputhshëm, si strehim i improvizuar për jetimët e rritur e të pastrehë. Një nga pasojat e shumta negative të kësaj gjendjeje është se, nxënësit nga jetimoret shtetërore, mund të shihen nga shkollat e mesme profesionale me konvikt si "barra" të mundshme afatgjata. Një drejtore konvikti i tha Amnesty International: "*Unë nuk marr më vajza nga Shtëpia e Fëmijës sepse ato vijnë si nxënëse dhe pastaj mbeten këtu. Le të shkojnë në Casa Famiglia!*" Një zyrtar në Ministrinë e Arsimit i konfirmoi Amnesty International se, disa shkolla për arsye të ngjashme, nuk donin të regjistronin nxënës nga institucionet e përkujdesit social. Megjithatë, ka edhe keqardhje për gjendjen e tyre: në disa raste administratorët e konvikteve i thanë Amnesty International se ushqimi që mbetet i pakonsumuar nga mensat e nxënësve, i jepej këtyre ish nxënësve: "*Ndonjëherë ata [jetimët] rrinë pa bukë; këtu të paktën ata e hanë një pjatë gjellë.*"

Deri para pak kohësh konviktet ishin përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit, dhe, të paktën në parim, organet arsimore mund t'u kërkonin organeve bashkiake të përmbushin detyrimin për t'u gjetur strehim të rinjve të larguar nga përkujdesi, që kanë mbaruar shkollën. Por, që nga viti 2008, këto ndërtesa kanë kaluar gradualisht nën organet bashkiake.³⁴ Si rezultat, tani është Bashkia ajo që mund t'i kërkojë konviktit ta ofrojë këtë akomodim (madje edhe për të rinjtë e larguar nga përkujdesi që as nuk janë e as nuk kanë qenë nxënës të shkollës). Një drejtore konvikti i tha Amnesty International: "*Vetëm para pak muajsh kaluam nën varësinë e bashkisë, plotësisht. Nëse unë e përjashtoj një vajzë [për sjellje të keqe], problemi i mbetet bashkisë. Kur e largova X-in [një jetimë që nuk ishte nxënës], Bashkia erdhi tek unë që t'i jepja një vend të lirë kësaj vajze, sepse ata nuk duan që të kenë një vajzë në rrugë.*"

Një gjë është e qartë: konvikti nuk është zgjidhje e përshtatshme për nevojat e strehimit të jetimëve dhe të rinjve të tjerë që largohen nga përkujdesi. Duke u dhënë këtë formë të degraduar dhe të pasigurt strehimi, shteti nuk përmbush, por u bën bisht, detyrimeve të e veta ligjore. Ajo është një “zgjidhje” që nuk nxit zhvillimin e aftësive për jetën, pavarësinë financiare dhe përfshirjen shoqërore. Në qytete si Tirana, Shkodra, Vlora dhe Korça, këto “geto të jetimëve” u ofrojnë të rinjve të larguar nga përkujdesi mundësinë e një strehe, por kjo është një strehë që çon në përjashtim shoqëror dhe marginalizim. A., i cili sapo ka mbaruar shkollën e mesme profesionale, tha: *“Tani që kam mbaruar shkollën, me rregull duhet të iki nga konvikti, por mbase lëviz në katin e parë të konviktit me të rriturit. Ose mbase bëj ndonjë gjë tjetër ...”* Ai i kupton pasojat e një lëvizjeje të tillë: *“Të isha në gjendjen e jetimëve të katit të parë, nuk do të bëja kurrë fëmijë në ato kushte. Pa punë e pa të ardhura; ajo nuk është jetë.”*

4. BARRIERAT NDAJ AKSESIT NË STREHIM TË PËRSHTATSHËM

4.1. LARGIMI NGA PËRKUJDESI DHE PAS-KUJDESI – STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE REALITETI

Kur mbarojnë arsimin e mesëm, të rinjtë shqiptarë janë 18 vjeç e lart dhe, ligjërisht, janë në moshë madhore. Por shumica vazhdojnë të gëzojnë mbështetjen praktike dhe emocionale të familjes edhe shumë më pas mbushjes së kësaj moshe; shumë prej tyre vazhdojnë të jetojnë me prindërit për disa vjet. Edhe të rinjtë pa kujdes prindëror shpesh kanë nevojë për mbështetje dhe strehë pasi mbushin 18 vjetët, siç njihet edhe në Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Përkujdesin Alternativ të Fëmijëve. Udhëzimi 27 thotë se parimet e Udhëzimeve janë të vlefshme edhe për të rinjtë “*të cilët kanë nevojë për përkujdes dhe mbështetje në vazhdimësi për një periudhë tranzicionale, pas mbushjes së moshës së pjekurisë, sipas legjislacionit në fuqi.*” Udhëzimet theksojnë se fëmijët duhet të përgatiten sistematikisht për jetë të pavarur dhe për largim nga përkujdesi shumë më përpara atij momenti, dhe kur është e mundur, gjatë kalimit në jetë të pavarur, duhet të kenë ndihmën individuale të një “personi të specializuar”.³⁵

Realiteti i fëmijëve që largohen nga përkujdesi shtetëror në Shqipëri është shumë i ndryshëm. Në vitin 2005, ekspertët e Drejtorisë së Shërbimit Social të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (Ministria e Punës) bënë një përmbledhje të gjendjes së të rinjve që largohen nga përkujdesi si më poshtë:

“Fëmijët janë të papërgatitur të jetojnë në mënyrë të pavarur pas moshës 18 vjeçare;

Nuk janë të siguruar me strehim dhe punësim pas mbarimit të shkollës.

Janë më të rrezikuar nga abuzimi seksual, shtatzënia e hershme, dhe përfshirja në rrjetet e trafikimit dhe prostitucionit.”³⁶

Për ta përmirësuar këtë gjendje, Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare për Fëmijë parashikonte “krijimin dhe forcimin e kapaciteteve në pikat e kontaktit që trajtojnë problemet e fëmijëve dhe të të rinjve në çdo bashki, qendër qarku”, dhe, sidomos për fëmijët në strukturat e përkujdesit, “programe të veçanta për t’i përgatitur fëmijët për jetesë të pavarur, kur dalin nga institucionet”. Megjithatë, këto synime janë ende larg së realizuari, siç mund të shihen nga fjalët e mëposhtme të thëna nga tre të rinj që u intervistuan nga Amnesty International në qershor 2009:

“Kur mbarova shkollën vitin e kaluar s’më erdhi asnjë të më shpjegojë ku do shkoja apo çdo të bëhet me mua. Jo, nuk erdhi askush.”

“Nuk e di se çfarë do të ndodhë në shtator, pres ku do më çojë shteti. Më kanë thënë që do më lëvizin, po nuk e di se ku.”

“Nuk e di se ku janë prindërit, unë dua të mendoj se ata janë të vdekur... Jam i sëmurë, më bie të fikët herë pas here. ...nëse sëmurem nuk kam asnjë të afërm të kujdeset për mua. ... Unë nuk kam asnjë, jam krejt i vetëm. Nuk e di se çfarë do të më sjellë e ardhmja.”

Semestri kishte mbaruar dhe ata e kishin përfunduar shkollën e mesme. Ende vazhdonin të jetonin në konviktin e shkollës së mesme të hoteleri-turizmit në Tiranë. U kishin thënë se duhet të iknin deri në shtator 2009, kur do t'u ndërpriteshin edhe bursa e nxënësit dhe e drejta e ushqimit në mensë. Megjithatë, as ata, e as autoritetet kompetente, nuk kishin gjetur ndonjë gjë të sigurt për të ardhmen. Drejtori i konviktit i tha Amnesty International se i kishte kërkuar Ministrisë së Punës, Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtorit të Konvikteve të Shkollave të Tiranës të gjenin një zgjidhje për strehimin e këtyre të rinjve, por ende nuk kishte marrë ndonjë përgjigje. Inercia zyrtare nuk ka marrë fund: në fillim të prillit 2010 ata ende vazhdonin të jetonin në konvikt, me asnjë alternativë tjetër në horizont.

Duke pasur parasysh mungesën e ndihmës dhe mbështetjes gjatë kohës që bëjnë kalimin në jetën e pavarur, nuk është për t'u çuditur se ata i tmerron afrimi kohës kur duhet të lenë strehimin në konvikt dhe kur nuk do të kenë më të drejtën e bursës dhe të ushqimit falas. Sipas shpjegimeve të një nxënësi: *“Gjatë shkollës së mesme me qëllim ngela një vit në provime, që të rrija në konvikt edhe një vit tjetër. Nuk kisha ku të shkoja e as me çfarë të jetoja. Nuk zgjidha ndonjë gjë të madhe, por e shtyva edhe një vit me shpresën se do të gjeja punë.”*³⁷

4.2. KUADËR I PAMJAFTUESHËM LIGJOR PËR TË RINJTË QË LARGOHEN NGA PËRKUJDESI SOCIAL

Mungesa e mbështetjes dhe ndihmës për të rinjtë që largohen nga përkujdesi social, përshkruar më lart, është pjesërisht rezultat i një legjislacioni i pamjaftueshëm, por edhe i mos-zbatimit të dispozitave ligjore ekzistuese dhe shërbimeve të kufizuara sociale për ta.

Në Shqipëri nuk ka një legjislacion gjithëpërfshirës që të trajtojë largimin nga përkujdesi social. Megjithatë, ligji “Mbi Statusin e Jetimit”, i miratuar në vitin 1996, u garanton të drejta të rëndësishme atyre që përmbushin kriteret e përfitimit të këtij statusi: statusi i jetimit u jepet personave deri në moshën 25 vjeç që kanë kaluar ose jo nëpër institucione shtetërore a private të përkujdesjes shoqërore dhe që plotësojnë këto kritere a) janë të lindur jashtë martesë; b) nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit; c) u është hequr me vendim të formës së prerë të gjykatës e drejta prindërore e të dy prindërve (ose e njërit prind dhe prindi tjetër nuk jeton); d) që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk njihet identiteti i tyre. Ligji përcakton edhe procedurën për njohjen zyrtare të këtij statusi dhe të drejtat që rrjedhin prej tij.³⁸ Ndër to përfshihen e drejta e trajtimit me përparësi në strehim dhe me kredi afatgjata nga shteti. Përveç kësaj, zyrave vendore të punës, pjesë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, u kërkohet t'i japin përparësi punësimit të jetimëve, të cilët duhet të kenë përparësi edhe në programet e emigracionit të organizuara nga shteti. Këto të drejta, si dhe të tjera të specifikuar në ligj, zbatohen deri në moshën 25 vjeçare, si dhe pas kësaj moshe, *“nëse nuk janë trajtuar nga shteti me strehim dhe janë në kushte të vështira jetese”*.³⁹

Në praktikë, dispozitat që lidhen me strehimin dhe punësimin, të cilat i identifikojnë shumë saktë nevojat më jetësore të jetimëve në këtë fazë të jetës, ose nuk zbatohen (në fushën e strehimit) ose, edhe aty ku zbatohen (në fushën e punësimit), në përgjithësi nuk duket se janë efektive.

Megjithatë, dispozitat e ligjit “Për statusin e jetimit” lenë jashtë shumë të rinj që largohen nga përkujdesi, të cilët nuk i përmbushin kriteret e tij sepse kanë një ose dy prindër gjallë,

dhe nuk janë braktisur zyrtarisht. Por këta mund të jenë në kushte të ngjashme me jetimët që kanë marrë statusin, sepse edhe ata janë rritur në strukturat e përkujdesit shoqërore, dhe, për shkak të sëmundjes, paaftësisë, emigrimit të prindërve ose prishjes së familjes, janë njësoj pa mbështetje efektive prindërore dhe familjare. Kriteret e përcaktuara për marrjen e “statusit të jetimit” i përjashtojnë ata nga të drejtat e parashikuara me ligj, përfshirë edhe ato të drejta që shteti i zbaton, si për shembull e drejta (e të papunëve) për transport dhe shërbim shëndetësor mjekësor falas.⁴⁰ Ky dallim midis tyre është arbitrar dhe diskriminues, dhe bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare.

Amnesty International bën thirrje për miratimin e një legjislacioni gjithëpërfshirës për të gjithë të rinjtë që largohen nga përkujdesi, i cili të përfshijë procedura të qarta për përgatitjen e tyre sistematike për jetë të pavarur, ndër të cilat edhe caktimi i një personi të specializuar që do të lehtësojë tranzicionin e të riut ose të resë drejt pavarësisë dhe ta ndihmojë atë, sipas nevojës, të ketë akses në strehim, punësim, dhe shërbimet sociale dhe ligjore. Deri në miratimin e një legjislacioni të tillë, Amnesty International nxit zbatimin efektiv të dispozitave ekzistuese.

4.3. SHËRBIME TË PAMJAFTUESHME SOCIALE, LIGJORE ETJ., PËR TË RINJTË QË LARGOHEN NGA PËRKUJDESI

“Mungesa e strukturave dhe shërbimeve sociale që synojnë mbështetjen dhe integrimin e tyre përtej moshës 14 vjeçare, ka bërë që ata [të rinjtë që largohen nga përkujdesi] të jenë të padukshëm, të lënë pas dore, të diskriminuar dhe në luftë për të mbijetuar.”⁴¹

Të rinjtë që largohen nga përkujdesi i konviktit nuk kanë rrjetin familjar që mbështet të rinjtë e tjerë të kësaj moshe, e as një kujdestar ligjor, punonjës social, ose këshillues individual për t'i ndihmuar gjatë kalimit në jetë të pavarur. Një drejtor konvikti i tha Amnesty International: *“Për të pyetur për mundësi pune, trajnimi, një shtëpi, këta të rinj duhet të shkojnë në mini-bashkinë ku janë regjistruar dhe jo tek edukatori, sepse ata e kanë mbaruar shkollën. Ne nuk kemi më detyrime, pasi ata e kanë mbaruar shkollën. Janë punonjëset sociale që merren me këto çështje në mini-bashki. .. [Ata] janë tani në moshë madhore, dhe janë të përgjegjshëm për gjithçka që bëjnë. Sapo ato mbarojnë, ne si edukatorë jemi të detyruar t'u themi që të kërkojnë punë.”*

Megjithatë, tani për tani, shërbimet sociale shtetërore janë të kufizuara; ato rrallë mund të ofrojnë mbështetje praktike përveç shpërndarjes së ndihmës ekonomike. Në qershor 2009 kjo ndihmë luhatej nga 2600 në 3000 lekë në muaj –shumë që nuk mjafton as për të përballuar nevojat më elementare, dhe krejt e pamjaftueshme për të rinjtë që nuk kanë rrjetin familjar “të shpëtimit” (krahasuar me këtë, paga e detyruar minimale ishte 17800 lekë).⁴² Si pasojë, të rinjtë që largohen nga përkujdesi kanë pak burime në dispozicion, përveç mbështetjes së kufizuar të Shoqatave të Jetimëve, rrjetit të tyre shoqëror, përvojës së brezave të mëparshëm të jetimëve, dhe ndihmës nga një numër organizatash qeveritare ndërkombëtare (OQN), OJQ-sh, dhe fondacione fetare, që u ofrojnë një farë përgatitjeje profesionale ose punësim, shërbim shëndetësor, ushqime ose veshmbathje.

Edhe njohja zyrtare e statusit të jetimit për ata që i përmbushin kushtet, mund të paraqesë vështirësi. Të gjitha kërkesat duhet të shoqërohen me dokumentacion, dhe nxjerrja e këtij dokumentacioni mund të jetë me pagesë; mund të ketë edhe shpenzime të tjera për telefonata dhe, në disa raste, për të shkuar në vendin ku aplikanti ka pasaportizimin, ose në

Tiranë. Megjithatë, edhe po t'i lëmë mënjanë shpenzimet, edhe procedurat relativisht të thjeshta mund të përbëjnë pengesa serioze për të rinjtë që nuk kanë ndihmë për t'u orientuar në to për herë të parë dhe që nuk kanë aftësitë dhe përvojën e duhur jetësore. Në vitin 2008, Amnesty International financoi për gjashtë muaj një punonjëse sociale për t'i ndihmuar të rinjtë e larguar nga përkujdesi dhe jetimët në moshë madhore që dëshironin të bënin kërkesë për banesë sociale. Gjatë punës së saj, ajo takoi një numër të rinjsh që i përmbushnin kushtet për të pasur statusin e jetimit, por nuk e kishin marrë ende, sepse nuk kishin kush t'i ndihmonte. Puna dhe diskutimet me këta të rinj vunë në pah nevojën akute që shteti t'u verë në dispozicion punonjës socialë, të cilët mund të japin ndihmën përkatëse individuale për të gjitha çështjet që lidhen me largimin nga përkujdesi dhe periudhën e pas-kujdesit. Ndonëse përfaqësuesit e shoqatave të jetimëve mund t'u japin këtyre të rinjve një farë ndihme për akses në të drejtat e tyre, puna e tyre nuk mund të zëvendësojë mungesën e këtij shërbimi nga shteti.

Të rinjtë që largohen nga përkujdesi shpesh hasin edhe në një numër problemesh të tjera që pengojnë ushtrimin e të drejtave të tyre. Një nga këto është, për shembull, kur duan të bëjnë pasaportizimin në një vendbanim të ri, që mund të mos jetë vendi ku kanë lindur ose vendi ku banojnë prindërit. Ushtrimi të drejtave të ndryshme lidhet me bashkinë ose komunën ku banojnë, si mundësia e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve të tjera sociale, shërbimet shëndetësore vendore dhe e drejta për të bërë kërkesë për strehim dhe punësim në sektorin shtetëror. Por në disa raste, lidhjet e tyre me vendin ku janë regjistruar, mund të jenë shumë të dobëta. Zakonisht, ata kanë kaluar pjesën më të madhe të jetës në Shtëpitë e Fëmijës ose në institucione të tjera rezidenciale në Tiranë, Shkodër, Sarandë ose Elbasan, dhe shpesh, edhe vitet e shkollës së mesme, në qytetet e mësipërme ose gjetkë. Këto janë vendet që mund t'u japin të vetmen qëndrueshmëri dhe vazhdimësi në jetë, ku, më shumë se kudo gjetkë, kanë krijuar lidhje të vërteta me shokët e shoqet dhe kujdestarët. Përveç kësaj, mundësitë e punësimit në këto qytete, sado të pakta, mund të jenë shumë më të mëdha se në vendin ku janë të regjistruar si banorë. Por procedura e ndryshimit të vendbanimit nuk është e thjeshtë: dokumentacioni që duhet të shoqërojë kërkesën përfshin prova të pronësisë së apartamentit ku banon, ose (nëse banon me qira) vërtetime nga pronari i apartamentit të marrë me qira që provojnë pronësinë e tij mbi banesën që i ka dhënë me qira aplikuesit, së bashku me kontratën e qirasë të nënshkruar. Për të rinjtë që largohen nga përkujdesi dhe që janë të pastrehë, këto kushte janë të porealizueshme.

Të rinjtë që largohen nga përkujdesi gjithashtu do të kenë nevojë për ndihmë për mbushjen e formularëve të aplikimit për banesa sociale dhe për sigurimin e dokumentacionit përkatës. Të paktë janë ata që i kanë të qarta kriteret e zgjedhjes së aplikantëve (të përshkruara më poshtë) dhe, si rezultat, mund të bëjnë kërkesë për programe strehimi për të cilat nuk kualifikohen. Në fakt, mundësia e marrjes së një banese sociale shpesh u duket kaq e largët dhe e pamundur, sa që nuk kanë shtysë t'i plotësojnë formularët e aplikimit. Drejtorja e OJQ-së Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, i tha Amnesty International: "...ndonjëherë ata as nuk e dinë se duhet ta kenë emrin në listat [e strehimit]. Ata duhet ta kuptojnë se sa e rëndësishme është për ta që të jenë në këto lista."

4.4. E DREJTA E JETIMIT PËR STREHIM SIPAS LEGJISLACIONIT KOMBËTAR; LEGJISLACION JO KONSISTENT

Kushtetuta e Shqipërisë kërkon nga shteti të plotësojë nevojat për strehim të qytetarëve të

vet, “brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private” dhe të ofrojë “përkujdes dhe ndihmë për të moshuarit, jetimët dhe personat me paaftësi” (Neni 59). Për sa i përket jetimëve, ligji “Për statusin e jetimit” i vitit 1996, u garanton personave me statusin e jetimit të drejtën e trajtimit me përparësi në strehim; ai gjithashtu parashtron se ata duhet të përfitojnë nga kreditë afat-gjata shtetërore për blerjen e banesave (Neni 17). Kjo e drejtë vazhdon të gëzohet edhe pas moshës 25 vjeçare, “nëse ata [jetimët] nuk janë trajtuar nga shteti me strehim dhe janë në kushte të vështira jetese.” Siç shpjegohet në vijim, legjislacioni për banesat sociale, i miratuar në vitin 2004, përfshin personat me statusin e jetimit ndër grupet e cënueshme që duhet të kenë përparësi në strehim. Por ai u njehtë drejtat vetëm atyre që janë nën 30 vjeç dhe, si pasojë, është në kundërshtim me ligjin “Për statusin e jetimit” dhe ka veprim më të kufizuar se ai.

Një mospërputhje tjetër e rëndësishme është se, ndërsa ligji “Për Statusin e jetimit” e përkufizon të drejtën e jetimit për strehim në kuptimin e *blerjes* së banesës me anë të një huaje të subvencionuar nga shteti, ligji për strehimin social ka futur kriterin e të ardhurave si kusht për t’u përzgjedhur për programe të banesave me kosto të ulët. që zakonisht janë jashtë mundësive financiare të pjesës më të madhe të grupeve më të cënueshme, përfshirë edhe jetimët. Pra ai propozon një program për banesa sociale me qira për grupe të tilla. Banesat sociale me qira, të një standardi të përshtatshëm, janë një metodë e pranueshme e plotësimit të nevojave për strehim të të varfërve dhe njerëzve në nevojë; kjo është diçka e zakonshme në Evropë dhe në pjesë të tjera të botës. Por në Shqipëri opinioni i përgjithshëm mbështet fuqimisht pronësinë mbi shtëpinë; ky faktor, i mbështetur nga dispozitat e ligjit “Për statusin e jetimit”, i cili përmend të drejtën e kredive afat-gjata shtetërore për strehim, si dhe mungesa e banesave sociale me qira, i kanë shtyrë personat me statusin e jetimit të aspirojnë për të pronësi të një banese, edhe kur nuk i kanë të ardhurat që duhen për t’u përzgjedhur.

Për sa i përket procedurës për marrjen e banesave, sipas ligjit të vitit 1996, “Për statusin e jetimit”, me mbarimin e vitit të parafundit të shkollës, institucionet që trajtojnë jetimë, përfshirë dhe ato arsimore, janë të detyruara t’u dërgojnë statistika të sakta Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe organeve vendore të shërbimit social, që të merren masat për t’u siguruar jetimëve strehim (Neni 4). Kjo përgjegjësi institucionale për të filluar marrjen e masave për strehimin e jetimëve u ndryshua me një vendim qeverie të vitit 2002, që ia kalon përgjegjësinë jetimit i cili mund të bëjë kërkesë për shtëpi në organet vendore kur mbush 18 vjeç; pastaj organet qendrore, përmes Entit Kombëtar të Banesave, duhet të marrin masat për sigurimin e fondet e nevojshme.⁴³

Sidoqoftë, dispozitat e mësipërme në përgjithësi nuk janë marrë parasysh; në 12 vitet që nga hyrja në fuqi e ligjit “Për statusin e jetimit” nga 1996 në 2008, vetëm 29 nga 845 personat me status jetimi kanë marrë banesë sipas dispozitave të këtij ligji (asnjë prej tyre që nga viti 2005).⁴⁴

4.5. MUNGESA E TË DHËNAVE TË SAKTA PËR NEVOJAT E STREHIMIT TË PERSONAVE TË LARGUAR NGA PËRKUJDESI SOCIAL

Moszbatimi nga ana e shtetit i detyrimit për t’u dhënë personave me statusin e jetimit përparësi në strehim pasqyrohet edhe në faktin se mungojnë të dhëna të sakta në shkallë vendi për nevojat ose gjendjen e tyre të strehimit dhe as për nevojat dhe gjendjen e strehimit

të personave të rritur në strukturat e përkujdesit social në përgjithësi. Përveç 29 personave me status jetimi që kanë marrë banesë, nuk dihet, për shembull, sa prej personave me status jetimi që mbeten (816) kanë bërë kërkesë për banesë sociale dhe se cila është gjendja e tyre për sa i përket strehimit. Sipas statistikave zyrtare, në vitin 2007 në konvikte jetonin 226 jetimë të moshës madhore, kurse statistikave të bashkisë së Tiranës tregojnë se në periudhën dhjetor 2005 - mars 2010 kishin bërë kërkesë për shtëpi 185 persona me statusin e jetimit. Sigurisht, këto shifra nuk përbëjnë një bazë për vlerësimin e nevojave të sotme për strehim të jetimëve të regjistruar si të pastrehë dhe të personave të tjerë të larguar nga përkujdesi me nevoja të ngjashme për strehim. Por, sipas Drejtores së Politikave të Strehimit në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në vitin 2009 ishte parashikuar të bëhej një sondazh kombëtar për gjendjen dhe nevojat e të pastrehëve, ku përfshihej edhe një vlerësim i nivelit të të ardhurave të tyre, i cili do të shërbente si bazë për një strategji kombëtare të strehimit.⁴⁵ Shpresohet që këto të dhëna do të jenë të ndara në mënyrë të tillë që të zbulojnë nevojat për strehim të jetimëve dhe personave të tjerë që largohen nga përkujdesi, si dhe të grupeve të tjera në nevojë.

4.6. BARRIERAT NDAJ AKSESIT NË STREHIM NË TREGUN E LIRË

“... Dua të largohem nga konvikti, të gjithë duam, por ku të shkoj nuk e di. Gjëja më e mirë do të ishte të ishim disa vetë dhe të merrnim një shtëpi me qira, por është e vështirë... Nuk ka siguri se punën që kam do ta kem për shumë kohë; po sikur të humbas punën, çfarë të bëj me qiranë?” (një djalë 24 vjeçar)

Që të jetojnë në siguri dhe me dinjitet, jetimët dhe personat e tjerë që largohen nga përkujdesi kanë nevojë për një punësim të sigurt dhe të ligjshëm, i cili do t'u bëjë të mundur të paguajnë për strehimin, qoftë në sektorin social apo në atë privat. Punësimi i ligjshëm ofron sigurime shoqërore dhe mundësinë e përdorimit të shërbimeve shëndetësore publike. Megjithatë, punë të tilla janë të rralla dhe niveli i papunësisë ndër të rinjtë është shumë i lartë.⁴⁶ Personat e rritur në institucionet e përkujdesit social shpesh ankohen për paragjykimet që kanë të tjerët ndaj tyre, që mund të bëhen pengesë edhe për gjetjen e një pune. Një punonjëse e Fondacionit Madonnina del Grappa në Shkodër i tha kështu Amnesty International: *“Këto vajza vuajnë nga një stigmë shumë e madhe kur dalin në qytet për të kërkuar punë dhe për të jetuar si çdo person tjetër ... Duhet të shkojmë ne e t'i marrim vajzat për dore që të kërkojmë punë bashkë.”*

Megjithatë, niveli i ulët i kualifikimeve dhe aftësive për jetën të shumë të rinjve që largohen nga përkujdesi, janë ndoshta pengesa më kryesore për gjetjen e një pune që ofron të ardhura të mjaftueshme për të jetuar. Nga përvoja e qendrës TAG, e cila i mbikëqyr nga afër studimet e nxënësve për të cilët përkujdeset, duket se kualifikimet e larta, siç mund të pritet, i shtojnë mjaft mundësitë e gjetjes së një pune që sjell të ardhura. Në qershor 2009 drejtori i qendrës TAG i tha Amnesty International se kur mbarojnë shkollën (sipas tij, rreth 25% vazhdojnë studimet e larta), brenda pak muajsh pas largimit nga përkujdesi, këta nxënës në përgjithësi arrijnë të gjejnë punë dhe të fitojnë të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur veten në mënyrë të pavarur.

Por nuk ndodh kështu me shumicën e të rinjve që largohen nga përkujdesi. Sipas një studimi të kryer në tetor-nëntor 2008, nga 47 të rinj e të reja të moshës 15-24 vjeç, që kishin banuar në të shkuarën në strukturat e përkujdesit rezidencial (shtetërore dhe private), 68% kishin mbaruar vetëm arsimin e detyrueshëm, 26% ishin në shkollë të mesme, ose e kishin

mbaruar atë; dhe 6% vazhdonin universitetin. Rreth dy të tretat e këtij grupi thanë se ishin të papunë; ata që kishin punë, ankoheshin se puna ishte në sektorin jo-formal, e pasigurt, dhe nuk u jepte aq të ardhura sa për të përballuar shpenzimet e jetesës.⁴⁷ Këto rezultate konfirmojnë atë që ka vënë re Amnesty International në intervistat me të rinjtë e larguar nga përkujdesi: se për shumicën e tyre, ato lloje pune për të cilat janë të kualifikuar, janë të pasigurta dhe të paguara keq, shpesh më pak se paga e detyrueshme minimale prej 17800 lekësh në muaj.

Pra, në përgjithësi, të rinjtë që largohen nga përkujdesi në Shqipëri, nuk mund ta përballojnë marrjen e një banese me qira (e aq më pak ta blejnë atë) në tregun e hapur. Banesat me qira janë të pakta: sipas Strategjisë Kombëtare të Përfshirjes Sociale 2007-2013, vetëm 5% e të gjitha banesave në Shqipëri jepen me qira.⁴⁸ Si pasojë, qiratë janë të larta.⁴⁹ Pa një mbështetje financiare shtesë, shumica e të rinjve që largohen nga përkujdesi, edhe në qoftë se e ndajnë banesën me persona të tjerë, thjesht nuk kanë të ardhura të mjaftueshme që t'u mjaftojnë për të paguar qiranë dhe shpenzimet e tjera të jetesës.

Kjo nuk ndodh vetëm me të rinjtë që largohen nga përkujdesi rezidencial shtetëror. Sipas një studimi të kryer në vitin 2008 me 14 të rinj që u larguan nga Fshatrat SOS në Tiranë, vetëm 50% e grupit të studiuar (larguar nga kujdesi në vitin paraardhës) ishin në punë. Më se gjysma e tyre fitonin më pak se 17800 lekë në muaj dhe, po ashtu, më se gjysma paguanin qira nga 15000 deri në 22000 lekë në muaj. Të gjithë merrnin ndonjë lloj mbështetjeje financiare nga Fshatrat SOS për të paguar qiranë.⁵⁰

Studimi përfundon: *“Të rinjtë shfaqin nivel të ulët punësimi (vetëm 50%), në punë me të ardhura të pakta (banakier, operator, punonjës në videotekë ose qendër interneti) dhe pa sigurime shëndetësore....Kjo kategori gjithmonë do të ketë vështirësi të integrohet në tregun e punës, pa kualifikimet profesionale që nevojiten. Nevojitet një fokus më i madh në aspektin edukativ që kjo kategori të arrijë pavarësinë ekonomike. Strehimi mbetet një nga problemet më shqetësuese për këtë kategori, gjë që kërcënon sigurinë e tyre fizike dhe pengon përballimin e jetës në mënyrë të pavarur. Të gjithë jetojnë në banesa me qira. Pavarësisht punës së tyre dhe ndarjes së qirasë së banesës me anëtarë të tjerë, e kanë të nevojshme (të domosdoshme) mbështetjen financiare të organizatës SOS për të përballuar një banesë me kushte normale jetese (raporti banorë/dhoma; aksesit tek uji i pijshëm, energjia elektrike, linja telefonike). Organizata SOS ka edhe programe të veçanta për të mbështetur të rinjtë në sigurimin e banesës. **Por mbi të gjitha shteti duhet të ndërmarrë përgjegjësitë që i takojnë në hartimin dhe implementimin e politikave sociale për të mbështetur me banesa sociale këtë kategori.**”*⁵¹ [Theksimi i shtuar]

5. POLITIKAT E QEVERISË PËR STREHIMIN DHE LEGJISLACIONI PËR STREHIMIN SOCIAL

5.1. DHJETËVJEÇARI I PARË I TRANZICIONIT (1991 DERI 2001)

Moszbatimi nga ana e disa qeverive të njëpasnjëshme shqiptare i të drejtës së personave me statusin e jetimit (dhe të grupeve të tjera me të ardhura të ulëta dhe atyre në nevojë) për përparësi në strehim, e ka shpjegimin tek politikat që në përgjithësi i kanë shpërfillur këto detyrime ligjore, duke u kushtuar më shumë vëmendje përparësive të tjera. Ashtu si shumica e vendeve të tjera post-komuniste, në vitin 1991 Shqipëria u gjend përballë sfidave ligjore dhe praktike që erdhën nga shndërrimi i një sistemi të mbështetur në pronën shtetërore në një tjetër në të cilin mbizotëronin prona private dhe ekonomia e tregut. Nga viti 1993, fondi i banesave shtetërore, shumë prej të cilave në gjendje mjaft të keqe, u privatizua me shpejtësi dhe iu shit banorëve ekzistues me terma të favorshme (ose u dha falas në rastin e banesave të vogla). Së dyti, u miratuan ligje që parashikonin regjistrimin e tokës dhe kthimin ose kompensimin e pronarëve, pronat e të cilëve ishin shtetëzuar ose konfiskuar pas vitit 1945. Por këto reforma kanë pasur një përparim shumë të ngadaltë, gjë që ka çuar në mosmarrëveshje të shumta dhe gjyqe të stërzgjatura pronësie.

Ndërkohë, heqja e kufizimeve në lirinë e lëvizjes, që ishte imponuar nën regjimin komunist, çoi në një eksod masiv të njerëzve nga fshati për në qytetet më të mëdha, në kërkim të punës. Kërkesat e larta për banesa në qytete dhe oferta e kufizuar shkaktoi një rritje të shpejtë të çmimeve dhe qirave të shtëpive. Mungesa e theksuar e banesave sociale ose atyre me kosto të ulët nëpër qytete, solli nga ana e vet krijimin e lagjeve informale të banimit në periferi të qyteteve. Në vitin 1993, me ndihmën e një huaje nga Banka Botërore, qeveria nisi një program për përfundimin e ndërtimit të apartamenteve të papërfunduara publike, duke krijuar rreth 8600 njësi banimi.⁵² Këto iu shitën me terma të favorshme, kryesisht me hua afatgjata, disa kategorive të familjeve të pastreha, të zgjedhura në përgjithësi në bazë të kriterëve politike, ndër të cilat: ish të burgosurit politikë, njerëz që kishin mbetur pa strehë sepse shtëpia ku kishin banuar u ishte kthyer pronarëve të mëparshëm, dhe më vonë, familjeve që humbën shtëpitë si rezultat i shembjes së skemave piramidale të investimit në vitin 1997.

Në vitin 2002, një studim për sektorin e strehimit në Shqipëri vuri në dukje një rritje të numrin të familjeve të pastreha në listat e pritjes së qeverisë. Në atë kohë, sipas studimit, qeveria kishte detyrime ndaj 46000 familjeve të pastreha të regjistruara nga 1992 deri në 1998, që klasifikoheshin në gjashtë kategori të mëdha, asnjëra prej të cilave nuk lidhej me kriteret e të ardhurave ose ato sociale.⁵³ Studimi vuri në dukje se:

“Strehimi social duket se nuk ka përparësi në rendin e ditës së qeverisë. Duke pasur parasysh se ka një numër të madh njerëzish në varfëri të vazhdueshme, do të ishte me vend që qeveria të merrte përgjegjësinë për të siguruar banesa, strehim social me qira dhe shtëpi me çmime të përballueshme prej tyre.”⁵⁴

5.2. LEGJISLACIONI PËR STREHIMIN SOCIAL DHE BARRIERAT NDAJ AKSESIT NË STREHIM SOCIAL

Hapat e parë për t'i trajtuar nevojat për strehim social të familjeve të pastreha me të ardhura të ulëta përmes legjislacionit u bënë në vitin 2001, me miratimin e një Plan Veprimi të Strategjisë Kombëtare të Strehimit. Tre vjet më vonë u miratua ligji "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane" (Ligji Nr. 9232 i datës 13.05.2004).

Dy programet kryesore të strehimit social të parashikuara në këtë ligj janë programe të banesave sociale me qira dhe programe të banesave me kosto të ulët, të ndërtuara ose të blera nga Enti Kombëtare i Banesave, të cilat pastaj blihen nga familjet me të ardhura të ulëta, që përfitojnë nga kreditë afatgjata të subvencionuara nga qeveria.⁵⁵ Sipas dispozitave të këtij ligji, këto programe financohen nga buxheti i shtetit, buxhetet e bashkive, dhe kontributet e donatorëve. Organet kryesore për zbatimin e ligjit janë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, së bashku me Ministrinë e Financave dhe të Punës, si dhe bashkitë. Organet bashkiake kanë për detyrë të hartojnë një plan të hollësishëm dhjetëvjeçar për zonën që qeverisin dhe të sigurojnë fondet e nevojshme; ato janë gjithashtu përgjegjëse për ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira.

Në praktikë, që nga miratimi i këtij ligji, janë krijuar shumë pak banesa sociale dhe konkurrenca për ato banesa që ekzistojnë është shumë e ashpër. Pengesat e shumta me të cilat ndeshen të rinjtë e larguar nga përkujdesi dhe grupet e tjera të rrezikuara e në nevojë që kanë nevojë për strehim social, ilustrohen nga komentet e një punonjëseje të shërbimit social në bashki dhe një punonjëseje sociale nga një OJQ në Shkodër (që ngjajnë shumë me komentet që iu shprehën Amnesty International edhe në qytete të tjera):

"Në Shkodër ka një kohë të gjatë që nuk ndërtohen banesa dhe ato nuk mund të ndërtohen me fondet e bashkisë. Ka edhe një mungesë të trullit shtetëror që e bën edhe më problematike situatën... Por kur Bashkia donte të ndante rreth 40 hyrje, rreth 4000 të pastrehë aplikuan. Këto banesa, si përfundim, në Shkodër, nuk u shpërndanë gjithsesi, sepse ishte e pamundur të përzgjidheshin nga një numër kaq i madh, për një numër kaq të vogël banesash."

"Në Shkodër është parë se realisht familjet që janë në listën e pritjes për shtëpi sociale janë familje me të ardhura normalisht të larta, sepse familjet që janë me të vërtetë në nevojë nuk janë në gjendje të plotësojnë kushtet e përzgjedhjes."

"Jemi munduar që jetimët e rritur t'i përfshijmë në kategorinë e parë të të pastrehëve, por nuk kemi mundur ta bëjmë. Jo të gjithë jetimët kanë aplikuar për banesë sociale, sepse jo të gjithë të rinjtë që kalojnë nga shtëpia e fëmijës në konvikt kanë të drejtën të marrin statusin e jetimit."⁵⁶

5.3. KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR STREHIM SOCIAL

Sipas ligjit "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", për t'u përzgjedhur për strehim social, familjet dhe individët nuk duhet të kenë në pronësi një banesë, dhe duhet të kenë një sipërfaqe banimi nën normat e strehimit të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike ku bëjnë pjesë, ose të kenë mbetur pa strehë si rezultat i

fatkeqësive natyrore. Ka edhe kritere të të ardhurave: programi i strehimit me qira trajton ata që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme, ndërsa programi i banesave me kosto të ulët i drejtohet atyre personave, të ardhurat e të cilëve bien brenda disa kufijve të përcaktuara me ligj.

Brenda këtyre kritereve, disa grupe kanë përparësi për sa i përket banesave sociale (Neni 5 i ligjit): familjet ose individët që nuk kanë përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore në vitin 1993, familjet ku kryefamiljarja është një grua e ve ose e divorcuar, familjet njëprindërore, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, invalidët e luftës dhe invalidët e punës, familjet me shumë fëmijë, çiftet e reja, familjet që kanë ndryshuar vendbanim për shkaqe punësimi - dhe jetimët deri në moshën 30 vjeç.⁵⁷

5.4. BARRIERAT NDAJ AKSESIT NË STREHIM SOCIAL ME KOSTO TË ULËT

“Jetimët ishin një prej kategorive prioritare për 80 apartamentet që u shpërndanë vitin e kaluar. Kur i shpërndamë ato, ne zbatuam ligjin, mbi bazën e sistemit të pikëve. Jetimët i skualifikuan që në fillim sepse të ardhurat e tyre mujore ishin të pamjaftueshme për të mbuluar kështu mujore të kredisë.”⁵⁸

Sipas ligjit “Për statusin e jetimit”, personat me statusin e jetimit kanë të drejtën e huave të subvencionuara nga shteti për të blerë banesë. Në praktikë, siç e kemi parë, jetimët kanë marrë banesë në këtë mënyrë në raste jashtëzakonisht të rralla. Me miratimin e ligjit “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” në vitin 2004, situata ka ndryshuar më tej. Dispozitat e tij nuk përputhen me ligjin “Për statusin e jetimit”, sepse ai cakton një kufi moshor (30 vjeç) në të drejtën e personave me statusin e jetimit për t’u trajtuar me përparësi për strehim social. Ai gjithashtu përcakton të ardhurat si kriter përzgjedhjeje për programin e strehimit social me kosto të ulët, një kriter që shumica e jetimëve dhe anëtarëve të tjerë të grupeve të rrezikuara e në nevojë nuk janë në gjendje t’i plotësojnë. Kohët e fundit kriteret e përzgjedhjes janë ndryshuar përsëri, me qëllim që të promovohet kthimi i pronave tek ish pronarët.

Në vitin 2005 qeveria premtoi se deri në vitin 2010 do të ndërtonte 4000 apartamente për familjet në nevojë dhe ato me të ardhura të ulëta. Por, deri në fund të vitit 2009, sipas të dhënave, qeveria kishte ndërtuar vetëm 1000 apartamente të reja (dhe kishte blerë 55 të tjera) për t’u blerë nga familjet me të ardhura të ulëta. Ndërkohë, në qytetet e mëdha dhe në zonat bregdetare janë bërë ndërtime të shumta private, por kërkesa për strehim social vazhdon të mbetet e lartë, dhe numri i familjeve të regjistruara si të pastreha në vitin 2008, ishte të paktën 40000.⁵⁹ Me një kërkesë të tillë kaq të madhe, dhe ofertë strehimi kaq të vogël, përzgjedhja e aplikantëve për blerjen e këtyre shtëpive ka shkaktuar kontradikta të mprehta, dhe, si pasojë, vonesa (rasti më i njohur është ai i Durrësit, ku 48 apartamente të përfunduara në vitin 2007 u shpërndanë vetëm në fund të shkurtit 2010, për shkak të luftës së brendshme në bashki).⁶⁰ Ka pasur gjithashtu edhe akuza për korrupsion në lidhje me përzgjedhjen e aplikantëve, si dhe për standarde të ulëta ndërtimi, si në Elbasan.

Pasi nuk e plotësoi objektivin e vet, në vitin 2009 qeveria krijoi një skemë, brenda programit të strehimit me kosto të ulët, që kishte për qëllim t’u mundësonte rreth 3000 aplikantëve për strehim me kosto të ulët, të blinin banesa në tregun e hapur. Megjithatë, nga kjo skemë, që do të vazhdojë deri në vitin 2012, do të përfitojë kryesisht një grup nga ata që duhet të kenë përparësi në strehimin social: familjet që nuk përfituan nga privatizimi i banesave publike në

vitin 1993, sidomos familjet që banonin në shtëpi që regjimi komunist ua kishte konfiskuar pronarëve të mëparshëm. Qëllimi është që këto familje (që do të përfitojnë nga kredi pa interes, sepse interesi do të subvencionohet nga shteti) të motivohen të blejnë shtëpitë e tyre dhe kështu t'ua lëshojnë banesat ku jetojnë pronarëve të mëparshëm, numri i të cilëve, sipas të dhënave, thuhet se është 3167.⁶¹ Përveç kësaj, sistemi i pikëve për përzgjedhjen e aplikantëve për programin e strehimit me kosto të ulët, i favorizon këto familje: Bashkia e Tiranës, për shembull, u ka dhënë atyre numrin maksimal të pikëve (20), kurse jetimët dhe disa grupe të tjera në nevojë kanë 10 pikë.⁶² Ndonëse qeveria ka shpallur se 3000 familje të tjera në nevojë (që nuk banojnë në ish prona private) do të mund të blejnë shtëpi në tregun e hapur, atyre kreditë do t'u jepen me kushte më pak të favorshme (me normë fikse interesi prej 3%).

Është e kuptueshme që për qeverinë është prioritet zgjidhja ligjore, tashmë shumë e vonuar, e pronësisë mbi tokën dhe pronën, ku përfshihet edhe kthimi i pronave; ajo është edhe një prej kushteve për anëtarësim në BE.⁶³ Më 28 prill 2009, Shqipëria bëri kërkesën zyrtare për t'u bërë anëtare e BE-së. Por skema e përshkruar më lart, favorizon në mënyrë të padrejtë vetëm njërin nga grupet që duhet të trajtohen me përparësi për strehim sipas ligjit "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", në kurriz të grupeve të tjera.

Ndonëse mund të ketë disa jetimë që banojnë në shtëpi me ish pronarë (Amnesty International ka dijeni për këto raste), kriteri i të ardhurave minimale për t'u përzgjedhur për këtë skemë, duke marrë parasysh kërkesën për parapagimin e një depozite prej 40% të vlerës të banesës, është i paarritshëm për familjet me të ardhura të ulëta. Në të gjitha rastet, të ardhurat mujore minimale që nevojiten për t'u kualifikuar për këtë skemë janë më të larta se paga e detyruar minimale mujore prej 17800 lekësh. Në rastin e bashkisë së Tiranës, e cila boton statistika të kërkesave për strehim, është e qartë se ky kriter i të ardhurave është përtej mundësive të shumicës së aplikantëve: nga 4497 aplikantë (3818 prej tyre për blerjen e banesave me kosto të ulët) të regjistruar në periudhën dhjetor 2005 - shtator 2009, më shumë se gjysma (2690) kishin të ardhura mujore nën 30000 lekë, dhe kështu, nuk plotësonin as kriterin për të marrë një apartament me një dhomë e një kuzhinë (të ardhurat minimale të kërkuara: 34356 lekë).⁶⁴ Në janar 2010, Këshilli Bashkiak i Tiranës botoi një listë prej 55 individësh dhe familjesh të përzgjedhura për marrjen e huave të subvencionuara për të blerë banesa në tregun e hapur: me përjashtim të katër rasteve, të ardhurat mujore të deklaruara prej tyre shkonin nga 35000 lekë në 103000 lekë.⁶⁵

Amnesty International nxjerr përfundimin se, për sa i përket programit të strehimit me kosto të ulët, përparësia që duhet të gëzojnë grupet në nevojë, ndër të cilët edhe personat me statusin e jetimit, është më shumë një përparësi imagjinare. Realiteti është se kriteret e të ardhurave për t'u përzgjedhur për këtë program, dhe përparësia që u jepet banorëve të ish pronave private në formën e huave pa interes dhe në sistemin e pikëve, flasin për të kundërtën. Kështu, personat me statusin e jetimit gjenden në situatën paradoksale që, nga njëra anë janë të klasifikuar si një nga grupet që kanë përparësi për sa i përket strehimit social dhe që kanë të drejtën ligjore për hua afatgjata të subvencionuara nga shteti për blerjen e shtëpive, kurse nga ana tjetër janë *de facto* të përjashtuar nga programi i strehimit me kosto të ulët.

Sipas mendimit të Amnesty International, shteti shqiptar ose duhet t'u dalë zot detyrimeve që ka sipas legjislacionit kombëtar ndaj personave me statusin e jetimit dhe t'u garantojë

atyre hua afatgjata me normë interesi të ulët dhe me kushte që ata mund t'i përmbushin, ose, nëse kjo nuk është e realizueshme, të mos vazhdojë me këtë imagjinim ligjor ndjellës. Cilado qoftë rruga e zgjedhur, duhet të ketë qartësi ligjore dhe një zbatim të qëndrueshëm të detyrimit ligjor të shtetit sipas të drejtës ndërkombëtare, për t'u siguruar strehim të përshtatshëm personave në nevojë, ku përfshihen jo vetëm personat që kanë statusin e jetimit, por edhe të rinjtë e tjerë që largohen nga përkujdesi, të cilat kanë nevoja po aq të ngutshme strehimi.

6. FORMA TË MUNDSHME ALTERNATIVE TË STREHIMIT SOCIAL

6.1. STREHIMI SOCIAL ME QIRA – NJË PROJEKT PILOT

Strehimi social me qira, ndonëse është i zakonshëm në shumë prej vendeve të Evropës, është një dukuri e re në Shqipëri, e futur me ligjin “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”. Është pikërisht ky program ai që u drejtohet me të vërtetë familjeve të varfra. Sipas burimeve qeveritare, për t’u përzgjedhur për këto apartamente, familjet duhet të kenë të ardhura minimale prej 3000 lekë për person në muaj; vlera e qirasë nuk duhet të kalojë 25% të të ardhurave familjare, dhe, pas pagimit që qirasë, të ardhurat e disponueshme të familjes nuk duhet të jetë më të ulëta se sa asistenca maksimale mujore që jepet nga shteti, që në fund të vitit 2009 ishte 7500 lekë për familje.⁶⁶

Megjithatë, deri më sot nuk ka përfunduar asnjë banesë sociale me qira, ndonëse ka filluar një projekt pilot i cili, ndonëse me pak vonesë, synon të ndërtojë një total prej 1100 apartamentesh në tetë bashki. Ky projekt bashkëfinancohet nga një hua e subvencionuar nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës (CEB), dhe nga bashkitë, me asistencë nga qeveria qendrore aty ku është e nevojshme. Bashkitë do të jenë pronaret ligjore të këtyre banesave dhe do t’i administrojnë ato, por nuk mund t’i shesin për dhjetë vitet e ardhshme. Si një nga tetë bashkitë që marrin pjesë në këtë projekt, Tirana – ku këto vitet e fundit nuk janë ndërtuar banesa sociale me kosto të ulët – po ndërton tani banesa sociale me qira, me ndihmën e fondeve nga CEB, që përbëhen nga 393 apartamente në periferi të qytetit, në lagjen Shkozë. Kati i parë do të ketë dyqane, një kopsht fëmijësh, dhe shërbime të tjera, që sipas burimeve të bashkisë, do të krijojnë vende pune për disa nga banorët e apartamenteve.

Amnesty International e mirëpret këtë nismë që, si projekt pilot, jep arsye për të shpresuar se më vonë do të zgjerohet për të plotësuar nevojat e shumë familjeve të tjera me të ardhura të ulëta. Megjithatë, organet bashkiake duhet të marrin masa që aplikantët të jenë plotësisht të informuar për kriteret e të ardhurave që duhen të plotësojnë për të marrë banesë sociale. Sepse nga mungesa e këtij informacioni, shumë njerëz që mund të kishin aplikuar për banesa sociale me qira, kanë aplikuar pa sukses për programin e strehimit me kosto të ulët. Preferenca e përgjithshme për ta pasur banesën në pronësi, ilustron nga regjistri i aplikimeve për banesa sociale në bashkinë e Tiranës: nga dhjetori 2005 deri në mars 2010, 4221 aplikuan për banesa me kosto të ulët, dhe vetëm 708 për banesa sociale me qira.⁶⁷

Nga ajo që ka vënë re Amnesty International, ndonëse disa persona me statusin e jetimit kanë bërë kërkesë për banesa sociale me qira, shumica e tyre kanë të njëjtën preferencë për pronësi mbi banesën dhe e shohin me një farë mosbesimi strehimin social me qira. Ata kanë shprehur shqetësimin se bashkitë mund t’i rrisin qiratë përtej mundësive të tyre financiare dhe pastaj t’i nxjerrin jashtë banesave. Ata kanë shprehur edhe shqetësimin për sigurinë e mbajtjes së apartamentit, duke pasur parasysh faktin se pas dhjetë vjetësh, bashkitë mund t’i shesin apartamentet që u janë dhënë atyre si banesa sociale. Këto shqetësime duhet të marrin përgjigje të qarta.

Një burim tjetër potencial i banesave sociale me qira gjendet në ndërtesat publike të papërdorura, që i kanë kaluar në pronësi bashkisë dhe që mund të transferohen ligjërisht në fondin e banesave me qira, siç parashikohet në ligjin “Për programet sociale për strehimin e

banorëve të zonave urbane”.⁶⁸ Siç sugjeroi një e re nga Tirana: *“Shteti duhet ta pajisë jetimin me shtëpi sapo ai del nga konvikti, se pastaj ne grumbullohemi të gjithë bashkë [këtu në konvikt] e numri rritet. Ka shumë ndërtesa të pabanuara që mund të rregullohen për jetimët, më mirë diçka e thjeshtë që nuk ka nevojë për shumë buxhet, sesa të ndërtojnë diçka nga fillimi.”*

Po kështu, në Shkodër një punonjëse e bashkisë, përgjegjëse për shërbimet sociale, i tha Amnesty International: *“Mendimi im ka qenë që bashkia të marrë një ndërtesë të pabanuar e ta rikonstruktojë, dhe të kthehet për banesa sociale për këtë kontingjent [jetimët].”*

Ndër sugjerime e tjera të bëra nga vetë jetimët e rritur ishte edhe privatizimi i ndërtesave publike (konvikteve) ku banojnë, në favor të tyre. Për këtë ka edhe precedentë: për shembull, në qershor 2009 qeveria dekretoi privatizimin e një ish fabrike tekstilësh dhe ndërtesën e ish Shkollës së Partisë në Tiranë, në favor të banorëve, ish-të përndjekur politikë. Shembulli i bashkisë së Durrësit tregon për një mjet tjetër për shtimin e fondit të banesave sociale: organet bashkiake, kur japin leje për ndërtim banesash, duhet të venë kushtin e dhënies së një pjese të ndërtesave për qëllime të strehimit social.

6.2. BONUSI STREHIMI PËR AKOMODIM PRIVAT

Ndërkohë, deri sa të përfundojë ndërtimi, rinovimi ose blerja e fondit të përshtatshëm për banesa sociale me qira, ligji “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” ofron një zgjidhje praktike për strehimin e njerëzve më në nevojë, e cila, me financimin e duhur, mund të zbatohet pa vonesë. Ajo nuk kërkon investime publike në shkallë të gjerë në planifikimin, ndërtimin, blerjen ose menaxhimin e banesave sociale. Sipas këtij programi, bashkitë subvencionojnë qiratë e apartamenteve të marra me qira në tregun e hapur. Ligji parashikon se shteti subvencionon deri në 50% të masës së qirasë, dhe në rastin e personave me statusin e jetimit, deri në 75%.⁶⁹

Ndonëse një opsion i tillë do t’u ofronte të paktën një zgjidhje afat-mesme jetimëve të rritur që kanë familje, ai është veçanërisht i përshtatshëm për të rinjtë që largohen nga përkujdesi. Ai do t’i ndihmonte të rinjtë të largoheshin nga konvikti pas mbarimit të shkollës së mesme; po kështu, do të siguronte që shteti të merrte nga OJQ-të përgjegjësinë e subvencionimit të qirave, për të cilat disa të rinj nga institucionet private rezidenciale do të vazhdojnë të kenë nevojë. Ky opsion do t’i nxiste të rinjtë që largohen nga përkujdesi që të ndajnë banesën dhe qiranë me të tjerë, duke lehtësuar kështu izolimin social me të cilin përballen shpesh, gjë që do t’u mundësonte atyre që janë rritur bashkë, por që nuk kanë lidhje familjare, të ruajnë marrëdhëniet me njëri-tjetrin ndërkohë që forcojnë pavarësinë e vet, deri sa, me kalimin e kohës, të krijojnë edhe familjet e veta. (Projektet e tanishme të strehimit social u kushtojnë më shumë vëmendje familjeve dhe ofrojnë një numër shumë të vogël apartamentesh-studio për beqarët.)

Për fat të keq, kjo mundësi përdoret shumë pak, ndoshta sepse bonuset e strehimit do të përbënin një barrë shtesë mbi buxhetet e kufizuara bashkiake.⁷⁰ Megjithatë, sipas ligjit “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, programet e strehimit social duhet të financohen edhe nga buxheti i shtetit dhe, sipas nevojës, edhe nga donatorët. Për këtë arsye, organet qendrore dhe vendore duhet të kenë angazhim më të madh për të siguruar fondet e nevojshme për financimin e bonuseve të strehimit për anëtarët më në nevojë të shoqërisë.

Ndonëse bonuset e strehimit për banesat në tregun e hapur duket se janë zgjidhja më e shpejtë dhe më e realizueshme për nevojat e ngutshme për strehim të familjeve me të ardhura të ulëta, sigurisht që nuk mund të ketë një zgjidhje gjithëpërfshirëse për gjithçka. U takon organeve qendrore dhe bashkiake shqiptare, në konsultim me palët e tjera të interesuara, përfshirë jetimët, të rinjtë që largohen nga përkujdesi, dhe grupet e tjera në nevojë, që të gjejnë mjetet më të përshtatshme për të plotësuar nevojat për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm financiarisht.

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

“Njeriu ka nevojë më tepër se sa për një copë bukë, ka nevojë të jetojë me dinjitet ... Jetimi mund të ketë dinjitet vetëm nëse ka një shtëpi.” (Nxënëse e shkollës së mesme që jeton në konvikt)

Sipas të drejtës ndërkombëtare shtetet kanë përgjegjësinë t'u japin “mbrojtje dhe asistencë të veçantë” fëmijëve pa kujdes prindëror. Standardet ndërkombëtare, të parashtruara në Udhëzimet e OKB për Përkujdesin Alternativ për Fëmijët, kërkojnë gjithashtu nga shtetet që t'u japin ndihmë individuale këtyre fëmijëve gjatë tranzicionit për në jetën e pavarur, dhe t'u japë atyre përgatitjen arsimore dhe profesionale të nevojshme për të qenë ekonomikisht të pavarur. Në praktikë, në Shqipëri, moszbatimi i plotë i këtyre standardeve do të thotë që shumë prej tyre, kur arrijnë moshën madhore, nuk mundën të sigurojnë strehim të përshtatshëm pa ndihmën e shtetit. Mundësitë e punësimit dhe strehimit janë të pakta, dhe shumë prej tyre nuk kanë kualifikimet dhe shprehitë e duhura për të gjetur punë që paguan mjaftueshëm për të përballuar strehim të përshtatshëm në tregun e hapur dhe shpenzimet e tjera të jetesës. Këto disavantazhe janë të zakonshme jo vetëm për të rinjtë e rritur në jetimoret shtetërore që dërgohen në shkolla profesionale me konvikt, por edhe për një numër të konsiderueshëm të rinjsh të rritur në institucione private.

Kushtet e mjerueshme në konvikt dhe pritshmëria që institucionet private të përkujdesit mund të vazhdojnë përgjithmonë të marrin përsipër përgjegjësinë financiare për të ndihmuar të rinjtë që largohen nga përkujdesi, tregojnë se shteti ka hequr dorë nga detyrimet e veta ligjore. Politikat dhe legjislacioni për strehimin social duhet të jetë konsistent dhe t'i përgjigjet realisht nevojave për strehim të njerëzve më të cenueshëm. Ato duhet të marrin parasysh nevojat e ndryshme të grupeve të ndryshme. Në rastin e njerëzve që janë rritur në institucionet e përkujdesit social, këto grupe përfshijnë jetimët në moshë madhore, disa prej të cilëve me familje e fëmijë, që kanë banuar për vite të tëra nëpër konvikte, në varfëri të thellë dhe përjashtim social. Fakti që disa kanë mbushur moshën 30 vjeç ose më shumë, pa pasur akses në strehim të përshtatshëm, vjen sepse shteti nuk ka zbatuar të drejtat e tyre, dhe moshë që kanë nuk duhet t'i përjashtojë nga trajtimi me përparësi për strehim social, përkundrazi.

Megjithatë, ka edhe të rinj që largohen nga përkujdesi, të cilëve duhet t'u sigurohet akses në strehim të përshtatshëm menjëherë sapo mbarojnë shkollën, ose kur nuk marrin më ndihmën financiare për pagimin e qirasë, që ua japin institucionet private të përkujdesit. Po kështu, duhet të njihen dhe përmbushen edhe nevojat e atyre që nuk plotësojnë kushtet për marrjen e statusit të jetimit. Amnesty International mendon se programet e ndryshme të strehimit social, që parashikohen në legjislacionin shqiptar, mund t'i përgjigjen nevojave të këtyre grupeve të ndryshme, si edhe grupeve të tjera të cenueshme, në qoftë se ekziston vullneti politik dhe investimi i duhur në burime njerëzore dhe financiare. Megjithatë, këto programe duhet t'i përgjigjen realisht këtyre nevojave; burimet e pakta nuk duhet të përdoren në favor të kauzës së kthimit të pronave, duke u ofruar kushte më të favorshme njërit grup aplikantësh në dëm të grupeve të tjera.

Në Shqipëri, përgjegjësia për financimin e strehimit social i takon si organeve qendrore, ashtu edhe atyre vendore. Proceset e decentralizimit, që kanë vazhduar këto vitet e fundit, u

kanë dhënë gjithnjë e më shumë përgjegjësi bashkive, duke shtuar kështu edhe tryshinë mbi buxhetet shpesh të kufizuara bashkiake. Që shteti shqiptar të përmbushë detyrimin e tij sipas të drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit kombëtar për t'u garantuar strehim të përshtatshëm qytetarëve të vet më të cenueshëm, ndër të cilët jetimët dhe të rinjtë e tjerë që largohen nga përkujdesi, midis qeverisë qendrore dhe organeve bashkiake duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë, pavarësisht përkatësive politike. Atje ku burimet vendore janë të pamjaftueshme, organet qendrore duhet të japin burime më të mëdha financiare, dhe, aty ku është e nevojshme, të kërkojnë ndihmë ndërkombëtare për të siguruar zbatimin e këtij detyrimi ligjor. Projekti për ndërtimin e apartamenteve sociale me qira, i ndihmuar nga CEB, është një shembull i kësaj ndihme. Nëse përfundon me sukses, shpresohet që ai do t'i hapë rrugë projekteve të tjera të ndihmuara për strehim social.

REKOMANDIME

NË LIDHJE ME TË DREJTËN PËR STREHIM TË PËRSHTATSHËM

Amnesty International nxit qeverinë shqiptare

- Të rishikojë ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", si dhe legjislacionin plotësues, për të siguruar qartësi dhe konsistencë, si dhe përfshirjen e të gjithë të rinjve që largohen nga përkujdesi dhe që rrezikohen të mbeten pa strehë, në listën e grupeve të cenueshme me të drejtën për t'u trajtuar me përparësi në strehim;
- Të rishikojë politikat aktuale të strehimit për të siguruar paanshmërinë e tyre dhe që financimi i programeve sociale t'i drejtohet atyre programeve që venë në qendër grupet më të varfra dhe më në nevojë;
- Të mbledhë të dhëna për nevojat për strehim të jetimëve dhe të të rinjve të tjerë që largohen nga përkujdesi, për të siguruar që ata të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u trajtuar me përparësi në strehim, në përputhje me traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në të cilat Shqipëria është palë;
- Në veçanti, të sigurojë që të rriturit e pastrehë me fëmijë, ose me probleme shëndetësore ose paaftësi, që jetojnë në konvikte, të kenë mundësi të marrin banesa të përballueshme financiarisht pa vonesë, pavarësisht nga mosha ose statusi i jetimit;
- Të marrë masa për plotësimin progresiv të së drejtës për strehim të përshtatshëm të të gjitha grupeve të pafavorizuara, duke caktuar fondet maksimale nga burimet në dispozicion dhe duke kërkuar bashkëpunim dhe ndihmë ndërkombëtare aty ku është e nevojshme, në përputhje me kërkesat e nenit 2.1 të KNDESK;
- Të mbështesë, me anë të financimit, trajnimit dhe monitorimit, kapacitetin e këshillave bashkiake për zbatimin e programeve të strehimit social, në përputhje me politikat decentralizuese të qeverisë;
- Të marrë masa për të siguruar që këshillat bashkiakë t'i shpërndajnë banesat sociale në bazë të procedurave transparente, të drejta, dhe të shpejta;

- Të deklarojë që Shqipëria i konsideron të detyrueshme Nenet 16 (e drejta e familjes për mbrojtje sociale, ligjore dhe ekonomike), 30 (e drejta për mbrojtje nga varfëria dhe përjashtimi social) dhe 31 (e drejta për strehim) të Kartës Sociale Evropiane (e Rishikuar).

Amnesty International u bën thirrje këshillave bashkiakë

- Të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të zbatuar në mënyrë të efektshme programet e strehimit social, me qëllim sigurimin e strehimit të përshtatshëm për të gjitha grupet e pafavorizuara dhe në nevojë, duke siguruar njëkohësisht respektimin e duhur të të drejtave të personave me statusin e jetimit, njëri nga grupet në nevojë, që trajtohen me përparësi sipas ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane";
- Deri sa të krijohet një fond i mjaftueshëm banesash sociale, të marrin masa që personat me statusin e jetimit që janë në moshë madhore, dhe personat e tjerë që largohen nga përkujdesi me nevoja të ngjashme strehimi, të trajtohen me përparësi për të pasur akses në një akomodim të standardeve të përshtatshme, ndër të tjera, edhe me anë të bonuseve të strehimit për banesa private, siç parashikohet në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004;
- Të caktojnë punonjës socialë që t'i ndihmojnë të rinjtë që largohen nga përkujdesi të aplikojnë për banesa sociale, duke i informuar ata plotësisht për programet e ndryshme të strehimit social që ekzistojnë, kriteret e përzgjedhjes, dhe, aty ku është e nevojshme, duke i ndihmuar të plotësojnë formularët dhe të marrin dokumentacionin e nevojshëm;
- Të sigurojnë që përfaqësuesit e shoqatave të jetimëve të përfshihen në komisionet bashkiake të strehimit, në përputhje me VKM nr. 53, datë 28.01.2005;
- Të sigurojnë që banesat sociale të ndërtohen me standarde të mira, duke pasur parasysh kriteret e "strehimit të përshtatshëm" të parashtruara nga KDESK në Komentin e Përgjithshëm 4 për nenin 11.1 të KNDESK;
- Të sigurojnë që shpërndarja e banesave sociale të jetë transparente, e drejtë dhe e shpejtë.

Amnesty International i bën thirrje Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë dypalësh dhe shumëpalësh:

- Të ndihmojnë organet qendrore dhe vendore shqiptare në plotësimin e detyrimeve të tyre për sigurimin e strehimit të përshtatshëm për personat e pafavorizuar dhe në nevojë, duke promovuar programet e strehimit social përmes asistencës financiare dhe teknike. Amnesty International gjithashtu u bën thirrje donatorëve ndërkombëtarë që ofrojnë asistencë të tillë që të mbikëqyrin ndarjen e banesave sociale, për të siguruar që ato t'i shkojnë të varfërve dhe personave në nevojë, dhe të njohin cenueshmërinë e veçantë të jetimëve dhe personave të tjerë që largohen nga përkujdesi me nevoja po aq të ngutshme për strehim.

NË LIDHJE ME TË DREJTAT E FËMIJËVE PA KUJDES PRINDËROR PËR MBROJTJE TË VEÇANTË

Amnesty International u bën thirrje autoriteteve shqiptare në nivel qendror dhe vendor

- Të zbatojnë politikat e parashtruara në Strategjinë Kombëtare për Fëmijë 2005-2010, dhe në Planin e Veprimit që e shoqëron atë, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë: mbështetje për familjet, për t'u mundësuar atyre të rrisin fëmijët dhe për të parandaluar braktisjen e fëmijëve; promovimin e alternativave të tjera përveç përkujdesit rezidencial, ndër të cilat përkujdesi ditor, kujdestaria dhe birësimi, me qëllim që t'i sigurohet fëmijës një mjedis familjar ose që i ngjan familjes;
- Të bëjnë ndryshimet e nevojshme legjislative në kriteret për pranimin e fëmijëve në përkujdes rezidencial, në mënyrë që fëmija të pranohet në institucion rezidencial vetëm në qoftë se alternativat e tjera, përfshirë edhe përkrahja për familjen për t'i mundësuar asaj rritjen e fëmijës, nuk janë në interesin më të mirë të fëmijës;
- Të zbatojnë të drejtat e jetimëve dhe fëmijëve të tjerë pa kujdes prindëror për “mbrojtje dhe ndihmë të veçantë” nga shteti gjatë gjithë fëmijërisë së tyre (pra, deri në moshën 18 vjeç) dhe, në rastin e fëmijëve që largohen nga Shtëpitë e Fëmijës, të sigurojnë që atyre t'u caktohen kujdestarë ligjorë, si dhe mbështetja dhe mbikëqyrja e duhur arsimore dhe emocionale, mundësisht në kushtet e grupeve të vogla. Të merren masa për të siguruar që ata të fitojnë arsimin dhe aftësitë e duhura praktike për jetë të pavarur;
- Të ofrojnë fondet dhe trajnimet e duhura në nivel bashkie, për të siguruar që politikat e qeverisë për decentralizimin e shërbimeve sociale dhe deinstitutionalizimin e përkujdesit për fëmijët të garantojnë efektivisht interesat më të mira të fëmijës, në përputhje me nenin 3.1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës;
- Të jenë në ballë të luftës kundër paragjyqimeve ndaj jetimëve dhe fëmijëve të tjerë në strukturat e përkujdesit social, duke vënë në shënjestër shkaqet që qëndrojnë në themel të disavantazheve nga të cilat vuajnë ata.

NË LIDHJE ME LARGIMIN NGA PËRKUJDESI

Amnesty International u bën thirrje autoriteteve shqiptare në nivel qendror dhe vendor

- Të bëjnë rishikimin e politikave, legjislacionit dhe praktikave ekzistuese për largimin nga përkujdesi dhe pas-kujdesin, në konsultim të ngushtë me të gjitha palët e interesuara, si dhe një studim të kujdesshëm të praktikave më të mira në Shqipëri dhe gjetkë;
- Të miratojnë, mbi bazën e këtij rishikimi, një legjislacion gjithëpërfshirës për jetimët dhe të rinjtë e tjerë që largohen nga përkujdesi, i cili duhet të përfshijë:
 - Procedura të qarta për përgatitjen e tyre sistematike për jetë të pavarur, përfshirë caktimin e një personi të specializuar që të lehtësojë tranzicionin e të riut drejt pavarësisë dhe t'i ndihmojë atij, sipas nevojës, që të ketë akses në strehim, punësim, dhe shërbime të tjera sociale, ligjore dhe shëndetësore;

- Dispozita që u garantojnë atyre përparësi në punësim dhe strehim të përshtatshëm, së bashku me mekanizmat procedurale që sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave;
- Masa për mbështetjen e vazhdueshme, mbikëqyrjen sistematike, dhe ndjekjen në vijimësi të të rinjve pasi largohen nga përkujdesi; kjo duhet të mundësojë mbledhjen sistematike të të dhënave mbi rezultatet, mbi bazën e të cilave të hartohen politikat e mëtejshme;
- Të zbatojnë programe të veçanta, të hartuara në bashkëpunim me të rinjtë që largohen nga përkujdesi, të cilat i përgatisin fëmijët dhe të rinjtë për jetë të pavarur, ku të përfshihen përgatitja e mëtejshme profesionale dhe kurse që i përgjigjen aftësive dhe interesave të të riut dhe kërkesave të tregut të punës;
- Deri në miratimin e legjislacionit gjithëpërfshirës për jetimët dhe të rinjtë e tjerë që largohen nga përkujdesi, të zbatohen dispozitat e legjislacionit ekzistues që u jep personave me status jetimi përparësi në strehim dhe punësim;
- Të krijojnë dhe forcojnë, me anë të fondeve dhe trajnimeve qendrore, shërbimet në komunitet për personat që largohen nga përkujdesi, përfshirë caktimin e punonjësve socialë me përgjegjësi specifike për lehtësimin e aksesit të të riut në strehim dhe punësim;
- Të krijojnë kushtet për zbatimin efektiv të politikave dhe legjislacionit që lidhen me largimin nga përkujdesi dhe pas-kujdesin, duke siguruar bashkërendim në nivel qendror dhe vendor, dhe duke përfshirë mekanizmat që i integrojnë edhe shërbimet e ofruara nga OJQ-të në një sistem të unifikuar referimi dhe përkujdesi.

SHËNIME

¹Komenti i përgjithshëm 4 i Komitetit të OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, *E Drejta për Strehim të Përshtatshëm*, UN Doc.E/1992/23, paragrafi 1.

²Paga e detyrueshme minimale mujore sipas ligjit ishte 17 800 lekë (afërsisht €128).

³ Amnesty International, Shqipëria: *'Pa shtëpi, pa jetë - jetimët dhe e drejta për strehim* (Indeks: EUR 11/005/2007)

⁴ Intervistat dhe takimet u kryen në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Sarandë dhe Korçë. Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, intervistat e përmendura në tekstin më poshtë i përkasin qershorit të vitit 2009.

⁵ Memorandum to the Albanian Government: *Orphans and other children deprived of parental care – Amnesty International's concerns* (Jetimët dhe fëmijët e tjerë pa kujdes prindëror - shqetësimet e Amnesty International (Indeks: EUR 11/002/2010).

⁶ Rezoluta A/RES/64/142, *Guidelines for the Alternative Care of Children* (Udhëzime për ë Përkujdesin Alternativ për Fëmijët), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 18 dhjetor 2009.

⁷ *Strategjia Kombëtare për Fëmijë* (2005-2010), Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 368, datë 31.5.2005; *Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare për Fëmijë*, VKM nr. 487, datë 30.6.2005.

⁸ Shih nenin 2.1 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK) dhe Komentin e Përgjithshëm 3 të Komitetit të OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK), *Natyra e Detyrimeve të Shteteve Palë*, UN Doc.E/1991/23.

⁹ *Metropol*, 7 prill 2010.

¹⁰ *Panorama*, 21 maj 2009.

¹¹ Shih edhe *Memorandum to the Albanian Government: Orphans and other children deprived of parental care – Amnesty International's concerns* (Jetimët dhe fëmijët e tjerë pa kujdes prindëror – Shqetësimet e Amnesty International) (Indeks: EUR 11/002/2010).

¹² Sipas statistikave zyrtare, papunësia e regjistruar në vitin 2009 ishte 12.7 për qind, ndonëse kjo shifër nuk përfshin të gjithë të papunët. Në gusht të vitit 2008, Ministria e Punës deklaroi se rreth 16% e popullsisë jetonte me më pak se 2USD në ditë. Sipas Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT), në vitin 2008 12% e popullsisë jetonte në varfëri. Kriza financiare globale i ka ngritur këto nivele, ndonëse, nga informacioni që ka Amnesty International, ende nuk ka shifra të sakta. Një raport i Bankës Botërore i vitit 2009, *The Crisis Hits Home, Stress-testing households in Europe and Central Asia* (Kriza godet në shtëpi, testimi i stresit në familjet e Evropës dhe Azisë Qendrore), thotë se shifra mund të jetë deri në 15%.

¹³ Shih Rezolutën A/RES/64/142.

¹⁴ Në vitin 2004, numri i fëmijëve në përkujdes për 100000 banorë të moshës 0-17 vjeç në

Shqipëri ishte 62.4. Shifra krahasuese nga rajoni: Maqedonia – 175.5; Kroacia – 403.9 dhe Bullgaria – 795.9. Burimi: Innocenti Social Monitor 2006.

¹⁵ Ndër to përfshihen Fshati i Fëmijëve SOS, Shqipëri, Tjetër Vizion, Shtëpia e Shpresës, Qendra Madonnina del Grappa.

¹⁶ Përkujdesi rezidencial, si shtetëror ashtu edhe privat, i nënshtrohet rregullimit me ligj dhe inspektimit nga shteti.

¹⁷ Shih Elsa Osmani, *Largimi i të rinjve nga kujdesi social dhe pavarësia*, Tiranë, 2008, f. 10, sipas të cilit, në vitin 2006, rreth 60% e fëmijëve në përkujdes vinin nga familje të varfra ose familje me probleme sociale. Drejtorët e jetimoreve, me të cilët folën përfaqësueset e Amnesty International në vitin 2009, konfirmuan se varfëria vazhdonte të ishte një prej shkaqeve kryesore për vendosjen e fëmijëve në kujdes social.

¹⁸ Në nëntor 2009 u raportua se në vitin 2010 asistenca ekonomike do të përfshinte çdo tremujor dhënien e pakove me ushqime për familjet në varfëri të skajshme. Shih gazetën *Albania*, 27 nëntor 2009.

¹⁹ Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 18 (2).

²⁰ Shih vëzhgimet përmbyllëse të Komitetit për raportin fillestar të dorëzuar nga Shqipëria për zbatimin nga ana e saj të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, *Concluding Observations of the Committee on the Rights of the Child, Albania* (Vëzhgime përmbyllëse të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës, Shqipëri), U.N. Doc. CRC/C/15/Add.249 (2005), 31 mars 2005, paragrafët. 44 dhe 45 (a) dhe (b).

²¹ VKM nr. 209, datë 12.04. 2006. *Strategjia Kombëtare për Fëmijë* (2005 – 2010), dhe Plani i Veprimit që shoqëron atë e bëjnë deinstitutionalizimin një objektivi kyç që do të arrihet përmes shtimit të mbështetjes për familjet, për t'u mundësuar atyre të kujdesen për fëmijët kur kjo është në interesin më të mirë të tyre, dhe duke promovuar birësimin, kujdestarinë dhe përkujdesin rezidencial në "Casa Famiglia".

²² VKM nr. 659, datë 17.10. 2005, "Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale".

²³ Cituar në *Country Rights Situation Analysis of Young People Ageing Out of Care in Albania* (Analizë e situatës së të drejtave për të rinjtë që mbushin moshën për të dalë nga përkujdesi - draft) - studim nga Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale, dhe Fshatrat SOS Shqipëri, Tiranë, janar 2009.

²⁴ VKM nr. 1211, datë 27.8. 2008, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2008-2009". VKM nr. 998, datë 30.09.2009 përmban dispozita të ngjashme për vitin shkollor 2009-2010.

²⁵ E drejta e të miturve pa kujdes prindëror për mbrojtje dhe asistencë të veçantë nga shteti garantohet edhe në Nenin 17 të Kartës Sociale Evropiane, e Rishikuar.

²⁶ Pika 8 e Udhëzimit 1934, datë 18 tetor 2007, të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta "Për procedurat e sistemimit të personave në institucionet rezidenciale, publike dhe private" parashikon transferimin e kujdestarisë, por nuk zbatohet.

²⁷ Neni 29.1(a) i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.

²⁸ KDESK, Koment i Përgjithshëm 4, *E drejta për strehim të përshtatshëm*, UN Doc.E/1992/23, paragrafi 7.

²⁹ E drejta për strehim të përshtatshëm njihet edhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (neni 27.3).

³⁰ KDESK, Koment i Përgjithshëm 4, *E drejta për strehim të përshtatshëm*, UN Doc.E/1992/23, paragrafët. 6, 8 (e) dhe 11.

³¹ Amnesty International, *Albania: 'No place to call home' – adult orphans and the right to housing* (Shqipëria: Pa shtëpi, pa jetë – jetimët dhe e drejta për strehim) (Index: EUR 11/005/2007).

³² KDESK, Koment i Përgjithshëm 4, *E drejta për strehim të përshtatshëm*, UN Doc.E/1992/23, paragrafi 8 (a deri g).

³³ Po aty, paragrafi 8 (d).

³⁴ Sipas VKM nr. 502, datë 16 prill 2008, të gjitha ndërtesat e konvikteve dhe administrimi i tyre u transferuan nga administrata qendrore (Ministria e Arsimit) tek bashkitë.

³⁵ Shih Udhëzimet 130 deri 135.

³⁶ Nga Strategjia e Shërbimit Social 200- 2010 : mpcs.gov.al/images/stories/files/strategjia-sherbimeve-sociale.doc

³⁷ Një vajzë nga një konvikt në Tiranë, cituar në *Country Rights Situation Analysis of Young People Ageing Out of Care in Albania* (Analizë e situatës së të drejtave për të rinjtë që mbushin moshën për të dalë nga përkujdesi - draft), studim nga Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale, dhe Fshatrat SOS Shqipëri, Tiranë, janar 2009.

³⁸ Për të marrë zyrtarisht statusin e jetimit, aplikanti duhet t'i dorëzojë Komisionit të Shërbimit Social Shtetëror dokumentacion që vërteton se ai/ajo i plotësojnë kushtet e mësipërme.

³⁹ Shih ligjin nr. 8153 , datë 31 tetor 1996, ndryshuar me ligjin nr. 9233, datë 13 maj 2004.

⁴⁰ *Strategjia Kombëtare për Fëmijë* (2005 to 2010) përfshin në objektivat e veta rishikimin e ligjit "Për statusin e jetimit", por, për fat të keq, kjo detyrë nuk figuron në Planin e Veprimit që e shoqëron atë.

⁴¹ *Assessment of the Child Care Service sand Institutions for Children without Parental Care* (Vlerësim i shërbimeve të përkujdesit për fëmijët dhe i institucioneve për fëmijët pa kujdes prindëror) Raport studimor i sponsorizuar nga UNICEF, Shqipëri, tetor 2005 nga Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale. (Arsimi i detyruar që atëherë është shtuar me një vit, dhe zakonisht përfundon në moshën 15 vjeçare).

⁴² Shih *Country Sheet Albania 2009* (Material informativ Shqipëria 2009) hartuar nga Country of Return Information Project, financuar nga Komisioni Evropian, që thotë: "Sistemi i sigurimeve shoqërore nuk mbulon minimumin e ekzistencës të grupeve të cënueshme sociale ... Përfitimi mesatar është i barabartë me më pak se 15% të nivelit të varfërisë ...".

<http://www.cri-project.eu/cs/cs-albania-en.pdf>

⁴³ VKM nr. 316, datë 4.07 2002.

⁴⁴ Shifra të Shërbimit Social Shtetëror në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tiranë, 2008. (Sipas një raporti në *Gazeta Shqiptare* të 4 mars 2010, tani ka 940 persona me status jetimi.)

⁴⁵ Kjo intervistë u zhvillua në dhjetor 2008.

⁴⁶ Mbi bazën e Sondazhit për Matjen e Standardit të jetesës (Living Standard Measurement Survey -LSMS) papunësia ndër të rinjtë përllogaritej të ishte deri në 31,9 % , sipas një studimi të ILO-Shqipëri: *Decent Work Country Programme Document 2008 – 2010* (Programi i punës së denjë për Shqipërinë 2008-2010).
http://www.ilo.org/public/english/region/eurpro/budapest/download/dwcp/dwcp_albania.pdf, page 2

⁴⁷ *Country Rights Situation Analysis of Young People Ageing Out of Care in Albania* (draft) Analizë e situatës së të drejtave për të rinjtë që mbushin moshën për të dalë nga përkujdesi” (draft), studim nga Qendra Kombëtare Shqiptare për Studime Sociale, dhe Fshatrat SOS Shqipëri, Tiranë, janar 2009, f. 14.

⁴⁸ Qeveria shqiptare, *Strategjia e Përfshirjes Sociale, 2007-2013 - 2 draft*, f. 20.

⁴⁹ Në nëntor 2008 qiratë minimale për apartamente me dy dhoma e një kuzhinë në rrethinat të Tiranës ishin 200 Euro (në qendër të Tiranës ishte dyfishi i këtij çmimi), dhe 120 Euro në rrethinat e Shkodrës (rezultate të kërkimeve me anë të telefonit dhe internetit nga Vluchtelingenwerk Vlaanderen dhe cituar në *Country Return Sheet Albania 2009*).

⁵⁰ Elsa Osmani, *Largimi i te rinjve nga kujdesi social dhe pavarësia*, Punim diplome i magjistraturës, Tiranë, shtator 2008, f. 36-38.

⁵¹ Po aty, f. 52, 53. Përkthim i Amnesty International.

⁵² *Albania: Housing with Social Purpose Project* (Shqipëria: Projekti i strehimit për qëllime sociale) (FIP 14145), mars 2006 (draft), f. 5.

⁵³ Studim i porositur nga Komisioni Ekonomik për Evropën i OKB-së, me kërkesë të qeverisë Shqiptare, *Country Profiles on the Housing Sector, Albania, 2002* (Profile të sektorit të strehimit, Shqipëria), f. 77.

⁵⁴ Po aty, f. 68.

⁵⁵ Një mundësi e tretë është t’u shitet trualli, së bashku me infrastrukturën e nevojshme dhe lejet e ndërtimit, familjeve që duan të ndërtojnë shtëpitë vetë.

⁵⁶ Për të aplikuar për strehim social nuk është e nevojshme të kesh statusin e jetimit, por ata që kanë statusin e jetimit janë ndër grupet që kanë të drejtën e trajtimit me përparësi në marrjen e banesave sociale.

⁵⁷ Aplikimet për banesa sociale bëhen pranë Drejtorisë së Strehimit Social në bashki. Aplikanti duhet të specifikojë fillimisht programin e strehimit që kërkon, dhe të japë informacion për familjen, si dhe për punësimin, të ardhurat familjare, gjendjen e tanishme të

strehimit, "statusin" (me paaftësi, invalid, ose jetim) të ndonjë prej anëtarëve të familjes. Nëse, në bazë të këtij informacioni, punonjësit e strehimit në bashki vlerësojnë se aplikanti i përmbush kriteret, ai ose ajo duhet të dokumentojë informacionin e dhënë në fazën e parë. Në qoftë se dokumentacioni është në rregull, aplikimet i kalohen komisionit të strehimit në bashki, që përzgjedh aplikantët mbi bazën e një sistemi pikëzimi. Sipas VKM nr. 53 të 28 janar 2005, komisionet bashkiake të strehimit duhet të kenë përfaqësues nga OJQ të regjistruara që mbrojnë interesat e grupeve të përmendura në nenin 5 të ligjit nr. 9232, datë 13 maj 2004.

⁵⁸ Zëvendës Kryetari i Bashkisë Korçë, intervistuar në dhjetor 2008.

⁵⁹ Sipas drejtorit të Entit Kombëtar të Banesave cituar në gazetën *Shqip*, 14 korrik 2008.

⁶⁰ *Shekulli*, 23 tetor 2009.

⁶¹ Shih Udhëzimin nr. 6257, datë 02.09.2008, lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Ministria e Financave, ndryshuar me Udhëzimin nr. 2348, datë 17 prill 2009. Sipas kësaj skeme, gjatë periudhës 2009-2011, këto familje do të mund të marrin kredi afatgjata pa interes për blerjen e shtëpive (interesi do të subvencionohet nga qeveria) nga Banka Kombëtare Tregtare. Në varësi të madhësisë së familjes dhe vendndodhjes së banesës, caktohen nivelet e çmimit të banesës që mund të blejnë, ndërsa të ardhurat e familjes duhet të bien brenda disa kufijve të caktuar minimale dhe maksimale. Kredia mbulon 60 % të çmimit të blerjes (80 % në se ofrohet garanci me një banesë tjetër më të vlefshme, për shembull, shtëpia e një të afërmi).

⁶² Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë, nr. 51, datë 19.12.2008.

⁶³ Më 5 shkurt 2009, në një seminar të sponsorizuar nga BE në Tiranë, për çështje që lidheshin me pronësinë në sistemin ligjor shqiptar (regjistrimi, kthimi dhe kompensimi i pronave, dhe legalizimi), Kryetari i Delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë, Ambasadori Helmuth Lohan, vuri në dukje se "...Titujt e qartë të pronësisë dhe siguria ligjore janë parakushte themelore për zhvillimin e begatë të vendit, tërheqjen e investimeve të huaja direkte, paqen sociale dhe proceset e integritimit evropian të vendit."
http://ec.europa.eu/enlargement/press_corner/whatsnew/albania_en.htm?Page=3

⁶⁴ <http://www.tirana.gov.al/?cid=1,161,2967>.

⁶⁵ Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë, nr. 23, datë 26.10.2009. Sipas të dhënave, në janar 2010 u përzgjodhën edhe 90 familje të tjera për të përfituar nga kjo skemë.

⁶⁶ Shih mpptt.gov.al

⁶⁷ Shih <http://www.tirana.gov.al/?cid=1,161,3324>.

⁶⁸ Neni 3 (c), ligji 9232, datë 13 maj 2004. Bashkia e Tiranës, për shembull, planifikon të përdorë ndërtesa ose toka që janë pronë e Bashkisë për të krijuar edhe 250 banesa të tjera sociale, shih <http://www.tirana.gov.al/?cid=1,161,1774>.

⁶⁹ Sipas sistemit të pikëzimit të zbatuar nga Bashkia Tiranë, për shembull, jetimët bëjnë pjesë në kategoritë e aplikantëve për bonuse strehimi që kanë numrin më të madh të pikëve (15). Shih Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr.51, datë 19.12.2008.

⁷⁰ Që nga viti 2007 Bashkia Tiranë ka financuar 140 bonuse strehimi; këto janë rezervuar

kryesisht për familjet banesat e të cilave janë prishur për shkak të punëve publike. Masa e bonuseve të strehimit në Tiranë shkon nga 6000 në 12500 lekë në muaj.



**DËSHIROJ
TË NDIHMOJ**

QOFTË NË NJË KONFLIKT TË NJOHUR
BOTËRISHT, APO NË NJË QOSHE TË
HUMBUR TË GLOBIT,
AMNESTY INTERNATIONAL
BËN FUSHATË PËR DREJTËSI, LIRI
DHE DINJITET PËR TË GJITHË, DHE
SYNON TË GALVANIZOJË
MBËSHTETJEN E PUBLIKUT PËR
NDËRTIMIN E NJË BOTE MË TË MIRË

ÇFARË MUND TË BËNI JU?

Aktivistet anekënd botës kanë treguar se është e mundur t'u bëhet qëndresë forcave të rrezikshme që po minojnë të drejtat e njeriut. Bëhuni pjesë e kësaj lëvizjeje. Luftoni ata që nxisin frikë dhe urrejtje.

- Bashkohuni me Amnesty International dhe bëhuni pjesë e një lëvizjeje mbarëbotërore që bën fushatë për t'i dhënë fund dhunimeve të të drejtave të njeriut. Na ndihmoni të kemi rezultat.
- Dhuroni për të mbështetur punën e Amnesty International.

Së bashku mund t'i bëjmë zërat tanë të dëgjohen.

Jam i/e interesuar të marr informacion të mëtejshëm për t'u bërë anëtar/e i/e Amnesty International.

Emri

Adresa

Vendi

adresa e postës elektronike (e-mail)

Dëshiroj t'i dhuroj Amnesty International (dhurimet pranohen në UK£, US\$ apo €)

Shuma

ju lutem debitori

Visa

Mastercard

Numri

data e skadimit

Nënshkrimi

Ju lutem dërgojeni këtë formular në zyrën e Amnesty International në vendin tuaj. Për zyrat e Amnesty International nëpër botë, vizitoni: www.amnesty.org/en/worldwide-sites

Nëse në vendin tuaj nuk ka zyrë të Amnesty International, ju lutem dërgojani këtë formular: **Amnesty International**, International Secretariat, Peter Benenson House, 1 Easton Street, London WC1X 0DW, United Kingdom

www.amnesty.org





NË KËRKIM TË NJË STREHE LARGIMI NGA PËRKUJDESI SOCIAL NË SHQIPËRI

Kur mbushin moshën madhore, jetimët dhe fëmijët e tjerë të privuar nga kujdesi prindëror që rriten në institucionet rezidenciale në Shqipëri, rrezikohen nga varfëria dhe marginalizimi. Pa mbështetjen dhe ndihmën e familjes, ata përballen me shumë vështirësi në sigurimin e strehimit dhe të punësimit. Ata mund të përfundojnë të banojnë për vite të tëra në banesa të përbashkëta gjysmë të shkatërruara, pa asnjë siguri qëndrimi, dhe në kushte që janë një fyerje e hapur për dinjitetin njerëzor.

Me gjithë politikat zyrtare për të zgjidhur këto dhe shqetësime të tjera, këta të rinj ende po presin përmbushjen e premtimeve për një arsimim më të mirë, mundësi më të mëdha punësimi, dhe strehim më të mirë.

Ky raport merr në shqyrtim vështirësitë që vazhdojnë të pengojnë aksesin e tyre në strehim. Për të rinjtë që largohen nga përkujdesi, mbështetja në periudhën e kalimit në jetën e pavarur është e pamjaftueshme. Ata kanë vështirësi shumë të mëdha për të gjetur një punë të sigurt, me pagë të mjaftueshme për të paguar akomodim privat me qira, ndërsa banesat sociale janë shumë të pakta, madje edhe për ata që kanë më shumë nevojë.

Mbi të gjitha, ka një mungesë vullneti nga ana e shtetit për të përmbushur detyrimet e tij sipas legjislacionit vendas dhe të drejtës ndërkombëtare, në zbatimin e të drejtës së jetimëve që largohen nga përkujdesi për t'u trajtuar me përparësi në strehim. Amnesty International u bën thirrje autoriteteve shqiptare dhe partnerëve të tyre ndërkombëtarë që të sigurojnë realizimin e së drejtës së këtyre individëve për strehim të përshtatshëm.

Amnesty International
International Secretariat
Peter Benenson House
1 Easton Street
London WC1X 0DW
United Kingdom

www.amnesty.org

Indeks: EUR 11/004/2010
maj 2010

STREHIMI ËSHTË NJË
E DREJTË E NJERIUT
AMNESTY
INTERNATIONAL

